



MANUALI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Për prindërit jokujdestarë

UDHËZIME PËR KËTË MANUAL

HYRJE 1

Përshkruan misionin e OCSS-së, që është t'i vendosë fëmijët të parët duke i ndihmuar të dy prindërit që të mundësojnë mirëqenien ekonomike dhe sociale, shëndetin dhe stabilitetin e fëmijëve të tyre.

MBËSHTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN DHE GJYKATA PËR ÇËSHTJET FAMILJARE 2

Shpjegon se Zyra për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën (Office of Child Support Services) dhe Gjykata për Çështjet Familjare janë agjenci të veçanta, si dhe shpjegon funksionet e tyre.

PËRCAKTIMI I ATËSISË/MËMËSISË 4

Një nga hapat e parë në procesin e mbështetjes financiare për fëmijën është identifikimi i prindërve të fëmijës. Kur prindërit nuk janë të martuar me njëri-tjetrin, nëna (e quajtur edhe prindi që e lind) shënohet në certifikatën e lindjes dhe babai, ose prindi tjetër, mund të përfshihet, mund të përcaktohet më vonë ose mund të identifikohet me anë të testit të ADN-së.

Ky seksion në manual shpjegon:

- Pse duhet përcaktuar atësia/mëmësia
- Si përcaktohet atësia/mëmësia

DËRGIMI I ÇËSHTJES NË GJYKATË 8

Hapi tjetër në procesin e mbështetjes financiare për fëmijën për prindërit jokuqdestarë është marrja e një fletëthirrjeje për një seancë gjyqësore, zakonisht nga Gjykata për Çështjet Familjare në zonën ku ata banojnë.

Ky seksion shpjegon:

- Si mund të paraqitni një marrëveshje në gjykatë për të marrë ose ndryshuar një urdhër
- Çfarë duhet të dini për seancën gjyqësore
- Pse duhet të paraqiteni në seancën gjyqësore
- Cilat dokumente duhet të sillni në gjykatë
- Si të paraqiteni në gjykatë
- Sa është shuma e mbështetjes financiare që pritet të paguani për fëmijën
- Si mund të kualifikohen prindërit jokuqdestarë me të ardhura të ulëta për një shumë më të ulët të mbështetjes financiare për fëmijën
- Çfarë ndodh pas seancës gjyqësore

PAGESA E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 14

Pasi të merrni urdhrin e gjykatës për detyrimin për mbështetjen financiare për fëmijën, punëdhënësit tuaj do t'i kërkohet të bëjë zbritje nga paga juaj për mbështetjen financiare për fëmijën ose juve do t'ju kërkohet ta paguani vetë mbështetjen financiare për fëmijën.

Ky seksion shpjegon:

- Si të paguani dhe çfarë është Njësia e Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare (Support Collection Unit (SCU))
- Si të kërkonti një shqyrtim në bazë të vështirësive
- Çfarë kërkohet të bëjë punëdhënësi juaj
- Si të merrni ndihmë për të gjetur një punë
- Nëse shpërnguleni ose ndërroni punë
- Nëse bëni kërkesë për falimentim
- Nëse i jepni para ose dhurata prindit kujdestar
- Ku shkojnë pagesat

KREDITI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT E FITUARA TË PRINDIT JOKUJDESTAR 20

KUJDESTARIA DHE VIZITAT 20

NDRYSHIMI I URDHRIT KUR NDRYSHON SITUATA JUAJ 21

Secili prind mund t'i kërkojë Gjykatës për Çështjet Familjare të ulë ose rrisë mbështetjen financiare për fëmijën kur ndryshojnë rrethanat e tij financiare.

Ky seksion shpjegon:

- Si mund të paraqitni një marrëveshje modifikimi në gjykatë
- Si të kërkonti një modifikim në gjykatë
- Kur fëmija më i madh mbush 21 vjeç
- Çfarë ndodh në seancën gjyqësore për një modifikim
- Rakordimi i kostos së jetesës

PROGRAMET E REDUKTIMIT TË BORXHIT PËR PRINDËRIT JOKUJDESTARË 24

VONESAT ME PAGESAT 26

Nëse nuk paguani mbështetjen financiare për fëmijën për një kohë të caktuar ose për një shumë të caktuar të prapambetur, kundër jush mund të ndërmerren veprime administrative dhe automatike të ekzekutimit të detyrueshëm.

Ky seksion shpjegon:

- Veprimet e automatizuara administrative të ekzekutimit të detyrueshëm
- Shumën e shtuar
- Kompensimin me anë të rimbursimit të taksave
- Pengimin e fitimeve të lotarisë
- Sekuestrimin e llogarisë bankare (i njohur gjithashtu si konfiskimi i pronës (PEX))
- Pezullimin e lejes së drejtimit të automjetit
- Denoncimin të Byroja e Kreditit
- Referimin të Departamenti i Tatimeve dhe Financës të shtetit të Nju-Jorkut (Division of Taxation And Finance)

- Refuzimin e marrjes ose rinovimit të pasaportave
- Refuzimin ose dhënien e përkohshme të licencave profesionale në qytetin e Nju-Jorkut
- Veprimet gjyqësore të ekzekutimit të detyrueshëm
- Kërkesën për shkelje
- Pjesëmarrje në Programin e Mbështetjes së Prindërve (Parent Support Program (PSP))
- Referim për ndjekje penale

SHFUQIZIMI I URDHRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 32

Në shtetin e Nju-Jorkut, urdhrat për mbështetjen financiare për fëmijën janë të vlefshëm zakonisht derisa fëmija juaj të mbushë moshën 21 vjeç.

INFORMACION PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR FËMIJËN/NDIHMËN PËR ÇËSHTJEN 34

Ky seksion shpjegon:

- Burimet në internet
- Adresat postare

NJOHJA E ATËSISË/MËMËSISË 36

Ju mund ta shihni një shabllon të urdhrat që përdoret për të përcaktuar vullnetarisht atësinë/mëmësinë e ligjshme pa qenë e nevojshme që të shkoni në gjykatë.

SHABLLON I URDHRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 38

Ju mund të shihni përmbajtjen e një shablloni të urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën dhe domethënien e tij.

FJALORTHI I TERMAVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN 40

HYRJE

HYRJE

Çdo fëmijë duhet të ketë të drejtën të mbështetet te të dy prindërit për dashuri dhe mbështetje financiare. Kjo vlen edhe kur të dy prindërit nuk jetojnë së bashku ose nuk kanë qenë kurrë të martuar me njëri-tjetrin. Është më mirë të përfshiheni me fëmijën tuaj që në lindje, por nuk është kurrë vonë për t'u bërë një prind i përgjegjshëm dhe i kujdesshëm. Një pjesë e të qenit prind i përgjegjshëm është sigurimi i mbështetjes financiare për fëmijën ose fëmijët tuaj.

Në qytetin e Nju-Jorkut, vizioni i Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS) për programin e mbështetjes financiare për fëmijën është që të përmirësojë jetën e fëmijëve. Misioni ynë është të ndihmojmë prindërit të marrin përsipër përgjegjësinë për qëndrueshmërinë ekonomike, mirëqenien sociale dhe shëndetin e fëmijëve të tyre. Ne e kuptojmë vlerën e jashtëzakonshme që kanë për fëmijët marrëdhëniet e shëndetshme me të dy prindërit.

Në OCSS ne ofrojmë disa shërbime për prindërit jokujdestarë (prindër që jetojnë veçmas nga fëmijët e tyre). Ne ofrojmë programe për t'i ndihmuar ata të përmbushin detyrimet e tyre për mbështetjen financiare për fëmijën dhe të menaxhojmë çështjet e tyre të mbështetjes financiare për fëmijën. Prindërit kujdestarë (prindërit që jetojnë dhe kujdesen për fëmijët e tyre në shumicën e rasteve) ne i ndihmojmë me përcaktimin e vendndodhjes së prindit jokujdestar, me përcaktimin e atësisë/mëmësisë në lidhje me prindin tjetër, me dorëzimin e fletëthirrjeve, me përfitimin e mbështetjes financiare dhe mjekësore sipas urdhrat të gjykatës, si dhe me arkëtimin dhe ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre urdhrave.

Shërbimet u ofrohen të gjithë prindërve pavarësisht nga të ardhurat apo statusi i imigracionit. Prindërit kujdestarë që marrin pagesa për mbështetje financiare për fëmijën dhe nuk përfitojmë ndihmë ekonomike, paguajnë një tarifë nominale vjetore prej \$35 kur të paktën \$500 pagesa për mbështetje financiare për fëmijën merren për ta nga OCSS.

Megjithëse shumica e prindërve jokujdestarë janë baballarët, në disa familje, babai është prindi kujdestar dhe nëna është prindi jokujdestar. Në familje të tjera, gjyshërit, ose të afërmit e tjerë janë kujdestarët kryesorë dhe si nëna ashtu edhe babai konsiderohen prindër jokujdestarë.

Informacioni në këtë manual është për të gjithë prindërit jokujdestarë. Ne ju inkurajojmë të lexoni këtë manual dhe të mësoni për të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja gjatë gjithë procesit të mbështetjes financiare për fëmijën. Ky informacion do t'ju ndihmojë të merrni vendime të informuara dhe të menaxhoni çështjen tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën për të arritur rezultatet më të mira për fëmijët tuaj.

MBËSHTETJA FINANCIARE PËR FËMIJËN DHE GJYKATA PËR ÇËSHTJET FAMILJARE

Shumë njerëz mendojnë se Gjykata për Çështjet Familjare dhe OCSS janë pjesë e së njëjtës agjenci. Kjo nuk është e vërtetë. Dy organizatat janë të ndara dhe kanë funksione të ndryshme në procesin e mbështetjes financiare për fëmijën.

- Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS) është programi për mbështetje financiare për fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut. Është pjesë e Administratës së Burimeve Njerëzore (HRA) të qytetit të Nju-Jorkut, një agjenci e Departamentit të Shërbimeve Sociale (New York City's Department of Social Services, DSS) të qytetit të Nju-Jorkut. OCSS është i ndryshëm nga gjykatat. Gjykatat janë institucion i veçantë. OCSS administron çështjet dhe pagesat për mbështetje financiare për fëmijën. Një çështje për mbështetje financiare për fëmijën fillon kur një prind kujdestar paraqet një aplikim të nënshkruar për mbështetje financiare për fëmijën ose informon gjykatën për interesin për të aplikuar për shërbime. Pasi gjykata lëshon një urdhër, OCSS monitoron dhe shpërndan pagesat për mbështetjen financiare për fëmijën. Nëse prindërit jokujdestarë kanë vonesa me pagesat e urdhëruara nga gjykata me një shumë të caktuar ose për një kohë të caktuar, OCSS zbaton automatikisht veprimet administrative të ekzekutimit të detyrueshëm për të mbledhur detyrimet e prapambetura.
- Në shtetin e Nju-Jorkut, mbështetja financiare për fëmijën është proces që zgjidhet në gjykatë. Gjykata për Çështjet Familjare është pjesë e sistemit të unifikuar të gjykatave të shtetit të Nju-Jorkut dhe lëshon vendime zyrtare për çështjet e mbështetjes financiare për fëmijën. Këto përfshijnë caktimin dhe ndryshimin e vlerës së urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën kur prindërit i depozitojnë kërkesë gjykatës, caktimin e urdhrave të ndihmës mjekësore për të garantuar sigurimin shëndetësor për fëmijët, caktimin e urdhrave për kujdesin për fëmijët dhe caktimin e urdhrave të atësisë, të cilat përcaktojnë babanë ligjor të fëmijës. Kur kërkohet, gjykata mund të zbatojë veprime gjyqësore të ekzekutimit të detyrueshëm nëse masat administrative të ekzekutimit të detyrueshëm nuk kanë dhënë rezultat.

Një qasje alternative

OCSS ka një program marrëveshjes që i lejon prindërit të bisedojnë me një përfaqësues të shërbimit të klientit të OCSS-së jashtë gjykatës rreth vlerës së urdhrit për mbështetje financiare për fëmijën përpara seancës gjyqësore. Marrëveshjet mund të përdoren për të lëshuar urdhra të reja ose për të modifikuar ato ekzistuese. Prindërit që plotësojnë kualifikimet

mund të arrijnë një marrëveshje duke biseduar me një punonjës social të mbështetjes financiare për fëmijën. Nuk është e nevojshme që të dy prindërit të jenë të pranishëm ose në telefon njëkohësisht.

- Përgatitet një marrëveshje duke përdorur të njëjtat rregulla si gjykata.
- Marrëveshja dorëzohet në gjykatë për miratim dhe konvertohet në urdhër pas miratimit.
- Gjykata kërkon që të dy prindërit të marrin pjesë në të paktën një seancë gjyqësore për t'u siguruar që kanë marrë pjesë vullnetarisht në proces dhe që i kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Ky program u ofron prindërve një qasje alternative për përcaktimin dhe modifikimin e urdhrave të mbështetjes financiare për fëmijën, i cili duhet të jetë më i shpejtë dhe më miqësor për prindërit krahasuar me procesin e zakonshëm.



PËRCAKTIMI I ATËSISË/MËMËSISË

Përcaktimi i atësisë/mëmësisë i referohet identifikimit ligjor të babait biologjik ose prindit tjetër kur prindërit nuk janë të martuar me njëri-tjetrin. Përcaktimi i atësisë/mëmësisë mund të bëhet në çdo kohë përpara se fëmija të mbushë 21 vjeç. Prindërit adoleshentë mund të përcaktojnë atësinë/mëmësinë pa pëlqimin ose nënshkrimin e prindërve të tyre.

Pse duhet përcaktuar atësia/mëmësia

- Për t'i dhënë fëmijës tuaj përfitime të tilla si: sigurim shëndetësor, mbështetje financiare për fëmijën, sigurime shoqërore, pension ushtarak, pension pleqërie, të drejtën për të trashëguar nga ju dhe akses në historikun tuaj mjekësor familjar.
- Për t'i pasur të dy emrat e prindërve në certifikatën e lindjes.
- Për të drejtën për të kërkuar vizita ose kujdestari me anë të Gjykatës për Çështjet Familjare.
- Për të drejtën për t'u konsultuar për vendimet në lidhje me të ardhmen e fëmijës nëse prindi kujdestar nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën ose fëmija ka një gjendje mjekësore.

Si përcaktohet atësia/mëmësia

NJOHJA VULLNETARE E ATËSISË/MËMËSISË

Nëse të dy prindërit bien dakord, ata mund ta nënshkruajnë formularin e Njohjes së Atësisë/Mëmësisë (Acknowledgment of Parentage, AOP) sapo të lindë fëmija, ose në çdo kohë derisa fëmija të mbushë 21 vjeç. Njohja e atësisë në spital, sapo lind fëmija, do të thotë që emri i babait do të shfaqet menjëherë në certifikatën e lindjes. Në rast të kundërt, ajo hapësirë e certifikatës së lindjes lihet bosh.

Pasi fëmija të largohet për në shtëpi nga spitali, atësia mund të përcaktohet ende përmes një procesi vullnetar duke kontaktuar OCSS-në ose Departamentin e Shëndetit dhe Higjienës Mendore të qytetit të Nju-Jorkut (New York City Department of Health and Mental Hygiene, DOHMH). Nëse atësia përcaktohet pasi fëmija largohet nga spitali, certifikata e lindjes do të ndryshohet për të përfshirë emrin e babait dhe, nëse kërkohet, do të ndryshohet mbiemri i fëmijës.

- Nuk është e nevojshme që prindërit ta nënshkruajnë formularin në të njëjtën kohë.
- Atësia mund të vendoset edhe nëse jeni në ushtri, në burg ose jashtë vendit.
- Nëse nuk jeni të sigurt se jeni prindi, mos e nënshkruani formularin AOP. Kërkoni një test të ADN-së nga OCSS-ja dhe prisni rezultatet përpara se të merrni atë vendim.

- Ju nuk duhet të kërkonit një test të ADN-së nëse keni një çështje për mbështetje financiare për fëmijën në gjykatë, sepse ajo do të trajtohet gjatë seancës gjyqësore.

ANULIMI I NJOHJES SË ATËSISË/MËMËSISË (AOP)

- Pasi AOP-ja të depozitohet në DOHMH, ai bëhet një dokument ligjor. Nëse ndryshoni mendje në lidhje me njohjen e atësisë, duhet t'i drejtoheni gjykatës me një kërkesë për anulimin e AOP-së. Nëse keni qenë 18 vjeç ose më shumë kur keni nënshkruar AOP-në, duhet të bëni depozitimin sa më shpejt që të jetë e mundur
 - » 60 ditë pas nënshkrimit të AOP-së, ose
 - » 60 ditë pasi t'i jeni përgjigjur ndonjë kërkesë gjyqësore për fëmijën.
- Nëse keni qenë më i vogël se 18 vjeç kur keni nënshkruar AOP-në, duhet të bëni depozitimin sa më shpejt që të jetë e mundur
 - » 60 ditësh pasi keni mbushur moshën 18 vjeç, ose
 - » 60 ditë pasi t'i jeni përgjigjur ndonjë kërkesë gjyqësore për fëmijën nëse ju është komunikuar e drejta tuaj për të anuluar AOP-në në një proces që lidhet me fëmijën.
- Pasi të kenë kaluar këto afate, mënyra e vetme për të kundërshtuar Njohjen e Atësisë/Mëmësisë në gjykatë është të paraqitni prova mashtrimi, kanosjeje ose gabimi fakti. Edhe në ato raste, gjykata mund të vendosë se është në interesin më të lartë të fëmijës të mos urdhërojë teste gjenetike dhe të vazhdojë t'ju identifikojë si babanë e tij.

PËRCAKTIMI I ATËSISË/MËMËSISË NË GJYKATË

Përcaktimi i prindit tjetër të fëmijës në gjykatë mund të jetë i nevojshëm nëse:

- Prindërit nuk mund të bien dakord për nënshkrimin e formularit AOP.
- Nëna është ende e martuar ligjërisht me dikë tjetër, megjithëse e di që burri i saj nuk është babai i fëmijës.
- Ka dyshime për identitetin e babait dhe secili prind refuzon testin e ADN-së.
- Jeni në gjyq në një seancë për mbështetje financiare për fëmijën dhe atësia nuk është përcaktuar ende.

Secili prind, ose DSS nëse fëmijët po marrin ndihmë në para, mund të depozitojë një kërkesë për të përcaktuar atësinë në gjykatë. Ju mund t'i drejtoheni gjykatës për të depozituar kërkesën ose të hapni në internet formularët e Shtetit të Nju-Jorkut DIY (Bëje Vetë) në nycourthelp.gov për të plotësuar kërkesën për atësinë (ose atësinë/mëmësinë) përmes një programi kompjuterik ndërveprues. Pasi të keni shkarkuar dhe nënshkruar kërkesën, duhet ta depozitoni atë në gjykatë. Kontrolloni faqen e internetit të gjykatave në nycourts.gov për mënyrën e depozitimit të kërkesës (për shembull: me postë, dorazi ose online). Do t'ju caktohet data e seancës gjyqësore dhe udhëzimet se çfarë të bëni më pas.

Kur atësia përcaktohet në seancë gjyqësore, lëshohet një urdhër për regjistrim dhe depozitohet në Departamentin e Shëndetësisë dhe Higjienës Mendore. Certifikata e lindjes do të ndryshohet për të përfshirë emrin e babait dhe për të ndryshuar mbiemrin e fëmijës nëse kërkohet.

ZYRA E REGJISTRIMIT TË ATËSISË SË PRETENDUAR

Si të përcaktohet atësia, informacioni i përcillet Zyra e Regjistrimit të Atësisë së Pretenduar (New York State Putative Father Registry, PFR) të shtetit të Nju-Jorkut, i cili mban një regjistër të etërve ligjorë për shtetin. PFR mund të konsultohet në çështjet e trashëgimisë, birësimi ose çdo çështje tjetër ligjore që kërkon njoftimin e babait të fëmijës.

TESTIMI I ADN-SË ME KOSTO TË ULËT

- Nëse ka dyshime për identitetin e babait biologjik, kërkoni testin e ADN-së. Kontaktoni regjistruarin e lindjeve në spitalin ku ka lindur fëmija, ose linjën OCSA ADN në numrin 929-221-5008. Nëse do të paraqiteni në gjykatë për një seancë për mbështetje financiare për fëmijën, magjistrati mbështetës mund të urdhërojë një test ADN-je nëse është e nevojshme.
- Nëse jeni në gjyq, nuk mund ta kërkoni vetë një test ADN-je. Kjo duhet të kërkohet gjatë seancës gjyqësore.
- Ju do të referoheni në një laborator të certifikuar nga shteti për testin e ADN-së me kosto të ulët. Kampionet e ADN-së merren në pjesën e brendshme të faqes së fëmijës dhe të të dy prindërve duke përdorur një tampon; testi është i shpejtë dhe pa dhimbje.
- Nuk është e nevojshme të shkoni në laborator në të njëjtën ditë me prindin tjetër.
- Nëse jeni nën 18 vjeç, laboratori mund t'ju kërkojë që të shoqëroheni nga njëri prind.
- Rezultatet do t'ju dërgohen me postë rreth dy javë pasi laboratori të marrë të gjithë kampionët.

- Nëse jeni duke paguar mbështetje financiare për fëmijën sipas urdhrit të gjykatës dhe dëshironi një test të ADN-së, kjo kërkesë duhet të bëhet në gjykatë.
- Nëse testi i ADN-së vërteton se ju nuk jeni babai biologjik, urdhri nuk do të shfuqizohet automatikisht. Do të kërkohet një seancë gjyqësore dhe do të merret një vendim që është në interesin më të lartë të fëmijës.
- Ka një kosto të vogël për të dy prindërit për të bërë testin e ADN-së jashtë procesit gjyqësor.



DËRGIMI I ÇËSHTJES NË GJYKATË

Urdhrat për mbështetje financiare për fëmijën janë dokumente ligjore që marrin formë të prerë në gjykatë. Secili prind mund të depozitojë një kërkesë në Gjykatën për Çështjet Familjare për një seancë për mbështetje financiare për fëmijën.

Nëse prindi kujdestar dhe/ose fëmija po aplikojnë ose marrin ndihmë ekonomike, Departamenti i Shërbimeve Sociale (i njohur gjithashtu si Administrata e Burimeve Njerëzore ose HRA) do të depozitojë një kërkesë në emër të fëmijës. Prindërve kujdestarë që marrin ndihmë ekonomike u kërkohet të bashkëpunojnë me shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën për të marrë përfitime të plota për familjet e tyre.

Prindërit kujdestarë që nuk përmbushin kërkesat për mbështetje financiare për fëmijën mund:

- t'u reduktohen përfitimet ekonomike me 25%
- të humbasin Medicaid-in për veten e tyre, dhe
- të mos kualifikohen për disa programe të ndihmës me qiratë

Prindërit kujdestarë mund të përjashtohen nga bashkëpunimi nëse ka "arsye të pranueshme", që zakonisht do të thotë dyshim për dhunë në familje.

Për më shumë informacion në lidhje me seancat dëgjimore për mbështetjen financiare për fëmijën, ju lutemi shikoni videon në internet të Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare të Fëmijës në [youtube.com/hranyc](https://www.youtube.com/hranyc).

Si mund të paraqitni një marrëveshje në gjykatë për të marrë ose ndryshuar një urdhër

Prindërve jokujdestarë dhe kujdestarë do t'u jepet mundësia për të lidhur një marrëveshje në mënyrë të vullnetshme përpara se të shkojnë në gjykatë. Kjo lloj marrëveshjeje bazohet në udhëzimet standarde të mbështetjes financiare për fëmijën të përdorura nga gjykata, por do të diskutohet nga prindi ose prindërit me një përfaqësues të shërbimit të klientit të Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS). Është një alternativë e procesit gjyqësor zyrtar dhe është krijuar për të qenë miqësore dhe mbështetëse, duke u mundësuar të dy prindërve mundësinë për të biseduar.

Për një marrëveshje:

- Një punonjës i OCSS-së e harton marrëveshjen sipas udhëzimeve dhe i ndihmon prindërit të mbledhin dokumentet e kërkuara.
- Paketa e miratuar e marrëveshjes dorëzohet në gjykatë për të caktuar një seancë gjyqësore.

- Zakonisht kërkohet vetëm një paraqitje në gjykatë që magjistrati mbështetës të sigurohet që prindërit e kanë arritur këtë marrëveshje vullnetarisht dhe për të miratuar marrëveshjen si një urdhër me pëlqim nga të dy palët.

Çfarë duhet të dini për seancën gjyqësore

- Ju nuk **do të** pyeteni për statusin tuaj të imigracionit në gjykatë ose në asnjë moment gjatë procesit të mbështetjes financiare për fëmijën.
- Gjykata për Çështjet Familjare është e ndarë nga Gjykata Penale dhe informacioni **nuk** ndahet.
- Kur depozitohet një kërkesë përcaktim atësie/mëmësie ose për mbështetje financiare për fëmijën, juve do t'ju vijë një fletëthirrje, ose me postë ose dorazi. Ajo do të përfshijë datën, orën dhe vendndodhjen e seancës, si dhe një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve që duhet të plotësoni, si edhe një listë të dokumenteve që duhet të kenë me vete në seancë.
- Për informacion të dobishëm mbi procesin gjyqësor dhe udhëzime se si të plotësoni formularët, shihni faqen e internetit të "Family Legal Care": familylegalcare.org ose videot për mbështetjen financiare për fëmijën në [youtube.com/hranyc](https://www.youtube.com/hranyc).
- Paraqitni sa më shumë informacion që mundeni për të ardhurat dhe shpenzimet tuaja. Një magjistrat mbështetës do të dëgjojë dëshminë nga të dy prindërit, do të shqyrtojë informacionin e paraqitur dhe do të përdorë Udhëzuesit për Mbështetjen Financiare për Fëmijën të Shtetit të Nju-Jorkut për të llogaritur vlerën e urdhrat për mbështetje financiare për fëmijën.
- Nuk është nevoja për avokat në Gjykatën për Çështjet Familjare, por mund të punësoni një nëse dëshironi. Nëse prindi kujdestar dhe/ose fëmija po marrin ndihmë ekonomike, një avokat do të jetë aty për të përfaqësuar Departamentin e Shërbimeve Sociale. Kjo për shkak se kur përfshihet ndihma ekonomike, kërkesa për shërbime për mbështetje financiare për fëmijën paraqitet nga Departamenti i Shërbimeve Sociale, jo nga prindi kujdestar.

Pse duhet të paraqiteni në seancën gjyqësore

- Ju kërkohet të jeni të pranishëm në seancën gjyqësore. Nëse nuk jeni në gjendje të merrni pjesë, kontaktoni gjykatën dhe kërkoni ndryshimin e datës.
- Nëse nuk jepni informacion të mjaftueshëm financiar ose nuk paraqiteni, magjistrati mbështetës mund t'ju urdhërojë përsëri të paguani mbështetje financiare për fëmijën duke lëshuar një urdhër standard. Meqenëse një urdhër standard nuk bazohet në të ardhurat tuaja të sakta, vlera mund të jetë më e lartë nga sa mund të përballoni të paguani.

- Pasi të lëshohet një urdhër standard, ju mund të paraqitni një kërkesë në gjykatë për të ulur vlerën. Deri atëherë, do të mbetet shuma e mbështetje financiare për fëmijën siç përcaktohet nga urdhri standard dhe çdo mbështetje financiare e papaguar mund t'ju bëjë objekt të veprimeve strikte të ekzekutimit të detyrueshëm.
- Nëse mendoni se nuk jeni babai, paraqituni në seancë dhe kërkonit një test të ADN-së.

Cilat dokumente duhet të sillni në gjykatë

Paraqitni sa më shumë prej informacioneve të mëposhtme që të mundeni:

- Dokument që tregon emrin dhe numrin tuaj të sigurimeve shoqërore ose ITIN (Numri Individual i Identifikimit të Tatimpaguesit)
- Deklaratë e Plotësuar Financiare (<https://bit.ly/FinDisclosure>) që erdhi me fletëthirjen tuaj (shihni videon e OCSS, "Si të plotësoni formularin e deklaratës financiare (Pjesët 1 dhe 2)" në [youtube.com/hranyc](https://www.youtube.com/hranyc))
- Vërtetim adrese
- Emri, adresa dhe numri i telefonit të punëdhënësit aktual ose më të fundit
- Karta e sigurimeve shëndetësore
- Vërtetim i të ardhurave dhe/ose përfitimeve:
 - » 3 listëpagesa më të fundit që detajojnë pagën
 - » Formulari W-2
 - » Letër nga punëdhënësi juaj që vërteton punësimin dhe pagën
 - » Kopja e deklaratës tatimore më të fundit me dokumentacionin bashkëngjitur
 - » Sigurimet shoqërore ose përfitime të tjera të invaliditetit
 - » Përfitimet e sigurimit për papunësinë:
 - » Deklarata bankare
 - » Vërtetim për ndonjë fëmijë tjetër ose ish-bashkëshorte që po mbështesni
 - » Vërtetim të shpenzimeve të familjes dhe biznesit, faturat e papaguara dhe kreditë

Për më shumë detaje rreth informacionit që kërkon gjykata në seancën për mbështetje financiare për fëmijën tuaj, shkoni në familylegalcare.org. Ju gjithashtu mund t'i dërgoni email OCSS në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me pyetjet tuaja ose të kërkonit një takim nëpërmjet telefonit. Përfshini numrin tuaj të telefonit, numrin e çështjes, pyetjet dhe oraret kur preferoni të kontaktoheni dhe një punonjës i shërbimit të klientit të OCSS do t'ju kontaktojë.

Si të paraqiteni në gjykatë

Gjatë seancës gjyqësore, ju dëshironi që magjistrati mbështetës të dëgjojë atë që keni për të thënë. Nëse dëshironi të merreni seriozisht, duhet të tregoni respekt për gjykatën:

- Mbërrini në kohë.
- Vishni veshje të përshtatshme si pantallona të gjata dhe një këmbishë me jakë dhe mëngë.
- Përgatituni me një listë të gjërave të rëndësishme që dëshironi të thoni.
- Flisni kur t'ju vijë radha.
- Mos iu drejtoni drejtpërdrejt prindit kujdestar.
- Jini të drejtpërdrejtë dhe të saktë kur flisni pasi koha është e kufizuar.

Sa është shuma e mbështetjes financiare që pritet të paguani për fëmijën

Ligji i Shtetit të Nju-Jorkut për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën (CSSA) përcakton shumën bazë të mbështetjes financiare për fëmijën në një përqindje fikse të të ardhurave të prindërve. Përdorimi i këtyre përqindjeve siguron që fëmijët të përfitojnë nga i njëjti standard jetese ashtu si do të përfitonin nëse prindërit e tyre do të jetonin së bashku. Kjo përqindje përdoret për të gjitha rastet kur të ardhurat totale të të dy prindërve nuk janë më shumë \$163,000. Në rastet kur të ardhurat totale janë mbi \$163,000, magjistrati mbështetës mund të vendosë nëse do të përdoren udhëzimet për përqindjet dhe mund të marrë parasysh informacione për të përcaktuar shumën e plotë të mbështetjes financiare.

Mund të shkoni në faqen e internetit të OCSS në nyc.gov/hra/ocss për të marrë një vlerësim të urdhrin të gjykatës për mbështetje financiare për fëmijën tuaj. Përdorni llogaritësin e mbështetjes financiare për fëmijën.

SI LLOGARITET SHUMA E URDRIT

Shuma bazë e mbështetje financiare është një përqindje e të ardhurave tuaja bruto minus taksat e qytetit të Nju-Jorkut, zbritjet e Sigurimeve Shoqërore dhe Medicare dhe çdo mbështetje financiare për fëmijën ose bashkëshorten që i paguhet një familjeje tjetër. Kjo varet edhe nga numri i fëmijëve të përfshirë. Të ardhurat mund të jenë paga nga një punë, shpërblimin e punonjësit, pagesat e invaliditetit, përfitimet e papunësisë, pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shumë burime të tjera të ardhurash. Ndihma ekonomike dhe SSI nuk konsiderohen të ardhura.

Nr. i fëmijëve	%
1	17%
2	25%
3	29%
4	31%
5+	të paktën 35%

Për shembull, nëse fitoni \$35,000 në vit pas zbritjeve të lejuara nga CSSA dhe keni një fëmijë, shuma bazë e urdhrit për mbështetje financiare për fëmijën do të jetë afërsisht \$115 në javë. Për dy fëmijë në të njëjtën familje, shuma do të rritet në \$168 në javë.

Përveç shumës së detyrimit bazë, urdhri për mbështetje financiare për fëmijën duhet të përfshijë mbështetje financiare mjekësore. Mbështetje mjekësore do të thotë kostot e kujdesit shëndetësor për fëmijën si pagesat për sigurimin shëndetësor, të zbritshmet dhe bashkëpagesat. Kostot e mbështetjes mjekësore ndahen mes të dy prindërve në bazë të të ardhurave që kanë. Secilit prind mund t'i kërkohet që ta regjistrojë fëmijën në një plan sigurimi shëndetësor nëse ofrohet përmes punës së tij ose saj.

Sigurimi duhet të ketë një kosto të arsyeshme për punëmarrësin dhe shërbimet mjekësore duhet të jenë të disponueshme aty ku fëmija jeton. Në urdhrin e mbështetjes financiare mund të përfshihen edhe shpenzimet e arsyeshme të shkollës dhe kopshtit. Këto shpenzime zakonisht ndahen mes dy prindërve në bazë të të ardhurave që kanë.

Mund të përfshihet edhe kujdesi për fëmijët. Si mbështetja mjekësore, ashtu edhe kujdesi për fëmijët i shtohen shumës së urdhrit bazë. Vini re! Prindërit jokujdestarë duhet t'i bëjnë kërkesë gjykatës që ta heqë kujdesin për fëmijët nga urdhri i tyre përpara se të ndërpresin pagesat.

KUR HYN NË FUQI URDHRI

Data e hyrjes në fuqi e çdo urdhri për mbështetjen financiare për fëmijën është data e depozitimit të kërkesës, jo data kur gjykata ka lëshuar urdhrin, apo data kur rrethanat tuaja kanë ndryshuar.

- Për shembull: nëse një kërkesë është depozituar më 1 tetor dhe urdhri për mbështetje financiare për fëmijën për \$115 në javë është lëshuar në një seancë dëgjimore më 5 dhjetor, prindi jokujdestar detyrohet të paguajë \$115 në javë duke filluar nga data 1 tetor. Kështu, më datë 1 dhjetor, prindi jokujdestar largohet nga gjykata me detyrimin prej \$1000 të asaj që quhet mbështetje financiare me efekt prapaveprues, që mbulon periudhën midis datës së depozitimit të kërkesës dhe datës së lëshimit të urdhrit.
- Në mënyrë të ngjashme, nëse keni filluar të jetoni dhe të kujdeseni për fëmijën tuaj në janar, por nuk keni paraqitur një kërkesë deri në qershor për të shfuqizuar (ndaluar) ose për të ndryshuar urdhrin për t'u bërë prindi kujdestar, do të mbeteni përgjegjës për çdo mbështetje financiare për fëmijën për periudhën janar – qershor.

Si mund të kualifikohen prindërit jokujdestarë me të ardhura të ulëta për një shumë më të ulët të mbështetjes financiare për fëmijën

Është shumë e rëndësishme të paraqiteni në seancën gjyqësore dhe të paraqitni informacionin tuaj financiar në mënyrë që magjistrati mbështetës të japë një urdhër bazuar në të ardhurat tuaja.

- Nëse të ardhurat tuaja vjetore janë nën rezervën e vetëmbështetjes financiare së shtetit të Nju-Jorkut, ose SSR, urdhri juaj për mbështetje financiare për fëmijën mund të përcaktohet me \$50 në muaj. SSR dhe niveli federal i varfërisë ndryshojnë çdo vit, shihni <https://www.childsupport.ny.gov/dcse/pdfs/CSSA.pdf>.
- Nëse të ardhurat tuaja vjetore janë nën nivelin federal të varfërisë për një person, urdhri për mbështetje financiare për fëmijën mund të përcaktojë \$25 në muaj dhe shuma e detyrimeve të prapambetura do të kufizohet në \$500. Shihni <https://aspe.hhs.gov/topics/poverty-economic-mobility/poverty-guidelines>.
- Nëse keni një punë me pagë të ulët ose nuk keni punë, magjistrati mbështetës mund t'ju referojë te Programi i Mbështetjes financiare së Prindërve (PSP). Do të referoheni në një organizatë që do t'ju ndihmojë të gjeni një punë. Pasi të filloni të fitoni më shumë para, shuma e urdhrit për mbështetje financiare për fëmijën tuaj mund të rritet në një seancë gjyqësore.

Çfarë ndodh pas seancës gjyqësore

- Nëse jepet një urdhër për mbështetje financiare për fëmijën, juve do t'ju jepet një fletë-udhëzues pagese që tregon shumën e urdhrit për mbështetje financiare për fëmijën dhe mënyrën se si të filloni të bëni pagesat. Do t'ju jepet gjithashtu një kopje e urdhrit, me shumë mundësi me postë. Ju mund të ktheheni në gjykatë në një datë të mëvonshme për të kërkuar një kopje.
- Lexoni urdhrin tuaj për mbështetje financiare për fëmijën, sigurohuni që ta kuptoni dhe mbani një kopje. Nëse nuk jeni dakord me urdhrin për mbështetje financiare për fëmijën, keni kohë 30 ditë nga data e lëshimit të urdhrit për të paraqitur një kundërshtim me shkrim në gjykatë. Një gjyqtar do të shqyrtojë procesverbalin e çështjes dhe do të vendosë nëse urdhri është i saktë ose nëse duhet ndryshuar. Në pjesën e pasme të kësaj broshure jepet shembulli i një urdhri për mbështetje financiare për fëmijën.
- Pasi urdhri të jetë futur në sistemin kompjuterik të mbështetjes financiare për fëmijën, do t'ju dërgohet një letër ku do t'ju tregohet se sa duhet të paguani dhe si të bëni pagesat. Lexoni me kujdes këtë letër për t'u siguruar që të gjitha informacionet janë të sakta. Kontaktoni OCSS për çdo korrigjim.

PAGESA E MBËSHETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Si të paguani dhe çfarë është Njësia e Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare (Support Collection Unit, SCU)

Ju jeni përgjegjës për pagesën e urdhrimit për mbështetje financiare për fëmijën tuaj. Nëse jeni në marrëdhënie pune, punëdhënësit tuaj do t'i dërgohet një njoftim me udhëzime si të mbajë nga paga pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën dhe t'i dërgojë paratë në OCSS. Pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën mund të mbahen gjithashtu drejtpërdrejt nga burime të tjera të ardhurash, duke përfshirë pensionin, pensionin ushtarak, sigurimet shoqërore, pensionin e invaliditetit dhe sigurimin për papunësinë. Pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën nuk mund të mbahen nga ndihma ekonomike ose përfitimet SSI. Nëse urdhri juaj për mbështetje financiare për fëmijën përfshin mbështetje financiare mjekësore, punëdhënësit tuaj do t'i dërgohet një njoftim për t'ju zbritur nga paga koston e përfitimeve të sigurimit shëndetësor.

- 1. Nëse ju si prind jokujdestar jeni i punësuar**, paga juaj është subjekt i konfiskimit. Mund të duhen disa javë nga koha kur jepet urdhri për mbështetje financiare për fëmijën derisa punëdhënësi juaj të zbrisë pagesat nga paga juaj. Deri atëherë, ju duhet t'i bëni pagesat në Qendrën e Përpunimit të Mbështetjes Financiare për Fëmijën të shtetit të Nju-Jorkut (New York State Child Support Processing Center).
- 2. Nëse jeni i vetëpunësuar**, duhet t'i bëni pagesat rregullisht në Qendrën e Përpunimit të Mbështetjes Financiare për Fëmijën të Shtetit të Nju-Jorkut.
- 3. Nëse nuk jeni i punësuar**, duhet t'i bëni pagesat drejtpërdrejt rregullisht në Qendrën e Përpunimit të Ndihmës së Fëmijëve në shtetin e Nju-Jorkut.

- Të gjitha opsionet e pagesave përmblihen në <https://on.nyc.gov/paymentmethods>.
- Përdorni aplikacionin në celular NYC Child Support – ACCESS HRA për të bërë pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën me një kartë krediti, kartë debiti ose PayPal: nyc.gov/childsupportmobile.
- Është e rëndësishme që pagesat t'i bëni në kohë. Nëse keni vonesa me pagesat dhe pagesat tuaja vijnë drejtpërdrejt nga puna juaj ose burimi tjetër i të ardhurave, shumat që do të zbriten rregullisht mund të rriten me 50% derisa shuma të shlyhet deri në datën e kërkuar dhe mund të jeni objekt i veprimeve të tjera të ekzekutimit të detyrueshëm. Kjo quhet "shuma shtesë" ose "shumë e shtuar".

Për shembull, nëse urdhri për mbështetje financiare për fëmijën është \$115 në javë dhe ju keni detyrime të papaguara, do të tarifoheni një shumë shtesë prej \$57.50 (50% e \$115) për një total prej \$172.50 në javë derisa të shlyeni shumën deri në datën e kërkuar.

Si të kërkonte një shqyrtim në bazë të vështirësive

- Nëse konfiskimi juaj rritet përkohësisht me 50% mbi shumën e rregullt të urdhrimit, shteti i Nju-Jorkut kujdeset që pagesa e kësaj shume shtesë të mos ju krijojë vështirësi duke i lënë të ardhurat tuaja nën rezervën vjetore të vetëmbështetjes financiare. Shihni <https://childsupport.ny.gov/dcse/pdfs/CSSA.pdf> për shumën e rezervës së vetëmbështetjes financiare për vitin aktual. Për shembull, nëse urdhri për mbështetje financiare për fëmijën është \$300 në muaj, shuma e shtuar do të jetë \$150, për një total prej \$450 në muaj. Nëse ato \$150 shtesë reduktojnë të ardhurat tuaja vjetore nën rezervën e vetëmbështetjes financiare, duhet të kontaktoni ose të vizitoni Qendrën Fizike të OCSS -së për Shërbimin e Klientit (OCSS Customer Service Walk-in Center) ose të dërgoni një email në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us dhe të kërkonte një "Shqyrtim në bazë të vështirësive".
- Një pjesë, ose e gjithë shuma shtesë prej \$150 mund të hiqet nëse mund të vërtetoni një vështirësi, por urdhri për mbështetje financiare për fëmijën nuk do të ndryshojë. Për të reduktuar shumën në urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën, i quajtur "modifikim për zbritje", mund të pyesni punonjës të Qendrës Fizike të Shërbimit të Klientit për një marrëveshje nëpërmjet MOTS (Modifikimi i Urdhrave Përmes Marrëveshjes), ose mund të paraqitni një kërkesë për modifikim në gjykatën ku është lëshuar urdhri.

Çfarë kërkohet të bëjë punëdhënësi juaj

Punëdhënësit tuaj i kërkohet me ligj që të mbajë nga paga juaj shumën e urdhëruar nga gjykata për mbështetje financiare për fëmijën dhe për mbështetje financiare mjekësore. Zbritjet e pagave për mbështetje financiare për fëmijën dhe mbështetje financiare mjekësore janë të njëjta për të gjithë dhe punëdhënësit janë të vetëdijshëm për këtë proces. Punëdhënësi juaj nuk mund t'ju pushojë nga puna, t'ju ngarkojë një tarifë ose t'ju diskriminojë në asnjë mënyrë për shkak të zbritjeve të mbështetjes financiare për fëmijën.

Nëse punëdhënësi juaj ka pyetje, mund të marrë ndihmë duke telefonuar Linjën Telefonike të Ndihmës të Shtetit të Nju-Jorkut për Mbështetjen Financiare për Fëmijën (New York State Child Support Helpline) në numrin 888-208-4485 dhe duke zgjedhur opsionin 2 (Punëdhënësit dhe Mbajtësit e të Ardhurave). Nëse keni shqetësime se punëdhënësi juaj nuk po ndjek ligjin, ju lutemi njoftoni OCSS-në me email në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us.

Ligji Federal për Mbrojtjen e Kreditit të Konsumatorit (CCPA): kufizon shumën që punëdhënësi juaj mund të marrë nga paga juaj. Shuma maksimale që mund të merret është një përqindje e të ardhurave tuaja të disponueshme (shuma e mbetur pas zbritjes së taksave federale, shtetërore dhe lokale dhe zbritjes së Sigurimeve Shoqërore dhe Medicare). Përqindja varet nga fakti nëse keni apo jo detyrime të prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën.

Udhëzimet e CCPA për IWO-të e fundit

Për urdhrat e mbajtjes në burim të të ardhurave të shtetit të Nju-Jorkut prej datës 29 gusht 2018 ose më vonë

Përqindja maksimale e të ardhurave të disponueshme që mund të mbahet...	...Kur prindi jokujdestar i plotëson këto kritere
50%	Nuk ka detyrime të prapambetura kualifikuese (të barasvlershme me 12 ose më shumë javë të mbështetje financiare aktuale)
55%	Ka detyrime të prapambetura kualifikuese (të barasvlershme me 12 ose më shumë javë të mbështetje financiare aktuale)

Për shembull:

Prindi jokujdestar ka një urdhër për mbështetje financiare për fëmijën

- Urdhri për mbështetje financiare për fëmijën është \$200 në javë
- Nuk ka detyrime të prapambetura
- Të ardhurat e disponueshme janë \$300 në javë
- Maksimumi që mund t'i mbahet është \$150 në javë (\$300 x50%)

Nëse punëdhënësi po paguan shumën e plotë prej \$200, atëherë prindi jokujdestar duhet të kërkojë që nga listëpagesa të rillojë zbritja për mbështetje financiare për fëmijën, sepse shuma që po mbahet është mbi kufirin CCPA. Në të njëjtën kohë, prindi jokujdestar duhet të kthehet në Gjykatën për Çështjet Familjare ku është lëshuar urdhri për mbështetje financiare për fëmijën dhe të depozitojë një kërkesë për modifikim për zbritje. Kjo sepse, edhe nëse punëdhënësi mban më pak nga paga e tij, shuma e urdhrat për mbështetje financiare për fëmijën nuk do të ndryshojë. Çdo ndryshim i urdhrat duhet të bëhet përmes procesit gjyqësor ose përmes një marrëveshjeje modifikimi nëpërmjet stafit të Shërbimit të Klientit OCSS.

Si të merrni ndihmë për të gjetur një punë

Nëse nuk keni mundësi të paguani mbështetjen financiare për fëmijën sepse jeni i papunë ose keni një punë që nuk paguan mjaftueshëm, ka programe që mund t'ju ndihmojnë:

- **Programi i Mbështetje së Prindërve (PSP)** lidh prindërit jokujdestarë me punësimin, trajnimin për punë, ndërmjetësimin, arsimin, klasat e aftësive për jetën dhe shërbime të tjera. Programi i ndihmon prindërit të përmbushin detyrimin e tyre për mbështetje financiare për fëmijën dhe të ndërtojnë marrëdhënie më të forta me fëmijët e tyre. Prindërit jokujdestarë mund të referohen pranë këtij programi kur paraqiten në Gjykatën për Çështjet Familjare për çështjen e mbështetje financiare për fëmijën të tyre.
- **TXT-2-Work** është një mjet vullnetar për kërkimin e punës që u dërgon banorëve të Nju-Jorkut që abonohen në shërbim informacione të përditësuara sa herë që shpallen vende pune dhe bëhen kërkesa për punë dhe jep këshilla për shkrimin e CV-ve.

Shpejtësia e informimit elektronik do të thotë që abonentët e TXT-2-Work mund të lexojnë dhe të aplikojnë për një vend pune brenda 24 orëve nga shpallja. Regjistrohu duke dërguar fjalën JOBS në 877877 ose duke plotësuar formularin online duke kërkuar NYC Business Link.

- **Workforce1** është një shërbim që ofrohet nga Departamenti i Shërbimeve të Bizneseve të Vogla i qytetit të Nju-Jorkut (NYC Department of Small Business Services). Ai përgatit dhe lidh kandidatët e kualifikuar me vendet e punës. Shërbimet ofrohen nëpërmjet një rrjeti Qendrash të Karrierës të Workforce1 të ngritura në të pesë lagjet e qytetit dhe janë të disponueshme për njujorkezët e moshës 18 vjeç e lart. Për më shumë informacion dhe vendndodhjet e Workforce1, [vizitoni nyc.gov/workforce1](http://vizitoni.nyc.gov/workforce1).
- **Jobs-Plus** është një program i mirënjohur punësimi për banorët e strehimeve publike të qytetit të Nju-Jorkut, që ofron vlerësim, gatishmëri në punë, trajnim, asistencë për kërkimin e punës, referime për mbështetje financiare sociale dhe shërbime të mbështetjes financiare për fëmijët.

Kontaktoni OCSS për të marrë një referim për një program pune. Për trajnimin për punë dhe të gjitha opsionet aktuale të punësimit, shkoni në <https://on.nyc.gov/jobsandtraining>.

Email: dcse.cseweb@dfa.state.ny.us

Nëse shpërnguleni ose ndërroni punë

Ju kërkohet me ligj të informoni OCSS-në nëse shpërnguleni, në mënyrë që ne të mund të qëndrojmë në kontakt me ju për çështjen tuaj. Nëse ndërroni punë, na njoftoni që të njoftojmë punëdhënësin tuaj të ri të mbajë pagesat e mbështetje financiare për fëmijën nga paga juaj. Çdo ndërprerje në pagesa do të rezultojë në detyrim të papaguar për mbështetje financiare për fëmijën dhe mund të çojë në masa strikte të ekzekutimit të detyrueshëm. Gjithashtu mund të humbisni informacione të rëndësishme për çështjen tuaj nëse nuk kemi adresën tuaj aktuale.

Nëse bëni kërkesë për falimentim

Kërkesa për falimentim nuk fshin detyrimin e mbështetjes financiare aktuale dhe të prapambetur. Detyrimi i mbështetjes financiare për fëmijën ka përparësi ndaj kreditorëve të tjerë, me përjashtim të IRS-së (Shërbimi për të Ardhurat e Brendshme) në situata të caktuara. Nëse tashmë e keni një urdhër për mbështetje financiare për fëmijën, zbritjet nga paga për mbështetjen financiare aktuale do të vazhdojnë. Lloji i falimentimit (që do të thotë cili kapitull i falimentimit) përcakton nëse vazhdon arkëtimi i mbështetjes financiare të prapambetur dhe cilat veprime të ekzekutimit të detyrueshëm zbatohen. Edhe gjatë periudhës së falimentimit mund të lëshohet një urdhër i ri për mbështetje financiare për fëmijën.

Nëse i jepni para ose dhurata prindit kujdestar

- Pasi lëshimit të urdhrin për mbështetje financiare për fëmijën për llogari të Njesisë së Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare (SCU), çdo dhuratë (në të holla ose jo) që i jepni fëmijës suaj nuk do të llogaritet brenda pagesës së detyrimit për mbështetje financiare për fëmijën suaj. Në mënyrë të ngjashme, të hollat që i paguani drejtpërdrejt prindit kujdestar nuk do të kreditohen në llogarinë tuaj të mbështetje financiare së fëmijës dhe si pasojë mund të dilni debitor në mbështetjen financiare për fëmijën.
- Prindërit kujdestarë që marrin përfitime të ndihmës ekonomike konsiderohen se kanë kryer mashtrime të mirëqenies nëse pranojnë pagesa të drejtpërdrejta për mbështetje financiare për fëmijën dhe nuk i raportojnë ato te Administrata e Burimeve Njerëzore të qytetit të Nju-Jorkut (NYC Human Resources Administration, HRA).
- Veshjet, pelenat dhe sendet e tjera që i jepni prindit kujdestar për fëmijën konsiderohen si dhurata. Ato nuk llogariten si pagesë për mbështetje financiare për fëmijën.

Ku shkojnë pagesat

- Nëse prindi kujdestar dhe/ose fëmija po marrin ndihmë ekonomike, familja ka të drejtë të mbajë deri në \$100 e parë (\$200 për 2 ose më shumë fëmijë) të mbështetjes financiare aktuale të fëmijëve të arkëtuar çdo muaj. (Mbështetja aktuale është shuma e duhur e identifikuar në urdhrin e gjykatës). Kjo quhet pagesë tranzitore ose bonus dhe jepet si shtesë e përfitimeve të ndihmës ekonomike. Gjithçka tjetër e përfituar mbi bonusin përdoret për të paguar Departamentin e Shërbimeve Sociale (DSS) për përfitimet e marra ekonomike.
- Për shembull, nëse një prind kujdestar ka një fëmijë dhe një shumë të përfitimit të ndihmës ekonomike prej \$500 dhe urdhri lëshuar për prindin jokujdestar është \$150 dhe paguhet \$100, prindi kujdestar merr një total prej \$600 (\$500 përfitim plus \$100 mbështetje financiare për fëmijën).
- Kur familja shkëputet nga ndihma ekonomike, urdhri për mbështetje financiare për fëmijën vazhdon të aplikohet përveç nëse prindi kujdestar kërkon shfuqizimin e tij. Të gjitha paratë e mbledhura të mbështetjes financiare aktuale i shkojnë drejtpërdrejt prindit kujdestar. Në disa raste, OCSS do të vazhdojë të mbajë mbështetje financiare të prapambetur si detyrim nga koha kur familja merri ndihmë ekonomike.
- Nëse prindi kujdestar nuk ka marrë asnjëherë ndihmë ekonomike, të gjitha pagesat i përcillen atij ose asaj.
- Kostoja e rritjes së një fëmije është shumë e lartë. Për familjet me një prind që fitojnë nën \$59,200 pa shlyer ende taksat, kostoja e vlerësuar për rritjen e një të porsalinduri deri në moshën 2 vjeç është \$11,450 në vit sipas raportit të Departamentit të Bujqësisë së SHBA-së "Shpenzimet për fëmijët sipas familjeve".



KREDITI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT E FITUARA NGA PRINDI JOKUJDESTAR

Ju mund të kualifikoheni për një kredit të tatimit mbi të ardhurat e fituara nga prindi jokujdestar në shtetin e Nju-Jorkut. Për të përfutur këtë kredit, duhet të paraqitni një deklaratë tatimore në shtetin e Nju-Jorkut dhe të përfshini formularin tatimor IT-209. Ju keni kohë deri në dy vjet për të kërkuar këtë kredit të tatimit. Për më shumë informacion, vizitoni <https://on.nyc.gov/4dsyl9T>.

KUJDESTARIA DHE VIZITAT

Urdhurat e kujdestarisë dhe vizitës nuk mund të lëshohen në një seancë gjyqësore për mbështetje financiare për fëmijën dhe nuk përfshihen në urdhrin për mbështetje financiare për fëmijën. Por ato janë çështje emocionale për prindërit. Edhe nëse nuk po e shihni fëmijën tuaj, ju jeni ende ligjërisht përgjegjës për të paguar mbështetjen financiare për fëmijën të urdhëruar nga gjykata. Nëse prindi kujdestar nuk ju lejon të shihni fëmijën tuaj ose nuk mund të bini dakord për çështje të tjera prindërore, përdorni ndërmjetësimin. Ndërmjetësimi mund t'ju ndihmojë të zgjidhni mosmarrëveshjet tuaja dhe të përmirësoni marrëdhënien me prindin tjetër. Kontaktoni ofruesit e ndërmjetësimit falas dhe me kosto të ulët të renditur në këtë seksion.

Secili prind mund të depozitojë një kërkesë në Gjykatën për Çështjet Familjare për një seancë gjyqësore për kujdestarinë dhe vizitat për të përcaktuar kujdestarinë zyrtare të fëmijës ose për të ushtruar të drejtat e vizitës. Se kush ka kujdestarinë ligjore do të diskutohet në një seancë tjetër, veçmas nga çështja e mbështetjes financiare për fëmijën. Megjithatë, urdhri për mbështetje financiare për fëmijën mund të merret parasysh nëse kaloni kohë të gjatë me fëmijën, sigurohuni që ta ngrini këtë çështje në gjykatë. Në seancë, gjykatësi ose gjyqtari mund t'i referojë prindërit për ndërmjetësim. Kjo është një mundësi për të dy prindërit që të arrijnë një marrëveshje që mund të bëhet urdher gjykate. Nëse nuk arrihet marrëveshje, prindërit duhet t'i drejtohen përsëri gjykatës dhe gjykatësi ose gjyqtari do të marrë vendimet e nevojshme.

Shërbimet e ndërmjetësimit janë gjithashtu të disponueshme pa e dërguar çështjen në gjykatë. Hyni në internet në bit.ly/MediationBrochure për një përshkrim dhe listë të këtyre shërbimeve. Prindërit mund të kontaktojnë drejtpërdrejt organizatat e mëposhtme për shërbime ndërmjetësimi falas ose me kosto të ulët:

- **QENDRA PËR NDËRMJETËSIM DHE TRAJNIM:** 212-799-4302 (të gjithë klientët, tarifë sipas orës)
- **SHËRBIMET E NDËRMJETËSIMIT NË KOMUNITET:** 718-523-6868 (banorët e Queens-it)
- **INSTITUTI PËR NDËRMJETËSIMIN DHE ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE:** 718-585-1190 (banorët e Bronx-it)

- **GRUPI I NDIHMËS LIGJORE TË NJU-JORKUT:** hrasupport@nylag.org (klientët me të ardhura të ulëta)
- **INSTITUTI I PAQES I NJU-JORKUT:** 212-577-1740 (Banorët e Brooklyn-it dhe Manhattan-it)
- **NDIHMA PËR PRINDIN:** 800-716-3468 (linjë telefonike falas dhe konfidenciale për prindërit që jetojnë të ndarë)

NDRYSHIMI I URDRIT KUR NDRYSHON SITUATA JUAJ

Si mund të paraqitni një marrëveshje modifikimi në gjykatë

Një alternativë ndaj procesit më të zgjatur gjyqësor për ndryshimin e një urdhri për mbështetje financiare për fëmijën është arritja e një marrëveshjeje midis të dy prindërve, e cila lehtësohet nga një punonjës i Qendrës Fizike të OCSS-së për Shërbimin e Klientit. Programi ynë, i quajtur Modifikimi i Urdhrave Përmes Marrëveshjes (MOTS), zakonisht kërkon paraqitje në një seancë të shkurtër gjyqësore që rezulton në lëshimin e një urdhri me pëlqim, për të cilin kanë rënë dakord të dyja palët. Seanca gjyqësore i jep magjistratit mbështetës mundësinë për t'u siguruar që modifikimi është kryer vullnetarisht dhe ju të dy i kuptoni të drejtat tuaja. Pa paraqitje në gjykatë, gjykata nuk do ta shndërrojë marrëveshjen në urdher me pëlqim.

MOTS u ofron të dy prindërve mundësinë për të diskutuar, për të bërë pyetje dhe për të arritur një marrëveshje për shumën e detyrimit për mbështetje financiare për fëmijën, me anë të udhëzimeve dhe llogaritjeve standarde për mbështetje financiare për fëmijën. MOTS është krijuar për t'u ofruar prindërve një proces mbështetës dhe miqësor për të modifikuar urdhrat ndaj tyre.

Si të kërkonti një modifikim në gjykatë

Urdhri për mbështetje financiare për fëmijën bazohet në informacionin e disponueshëm në kohën e seancës. Secili prind mund të paraqesë një kërkesë në Gjykatën për Çështjet Familjare për të modifikuar (ndryshuar) shumën e urdhrit për mbështetje financiare për fëmijën nëse ka një ndryshim thelbësor të rrethanave, ose nëse nevojat e fëmijës nuk po plotësohen.

- Nëse të ardhurat tuaja ndryshojnë (nuk përfitonit më orë jashtë orarit, humbni vendin e punës dhe merrni pension papunësie, filloni të merrni pension invaliditeti, etj.) dhe nuk keni më mundësi të paguani urdhrin për mbështetje financiare për fëmijën, duhet t'i drejtoheni menjëherë gjykatës ku është zhvilluar seanca juaj e fundit për mbështetje financiare për fëmijën dhe të paraqitni një kërkesë për modifikim për zbritje.

- Gjithashtu mund të hyni në internet në Formularët e Shtetit të Nju-Jorkut DIY (Bëje Vetë) në nycourthelp.gov dhe të plotësoni një kërkesë për modifikimin e mbështetjes financiare. Pasi ta shkarkoni kërkesën e plotësuar dhe ta nënshkruani atë, mund ta sillni ose ta dërgoni me postë në Gjykatën për Çështjet Familjare.
- Do t'ju caktohet data e seancës gjyqësore dhe udhëzimet se çfarë të bëni më pas. Prindi kujdestar duhet të njoftohet për t'u paraqitur në gjykatë. OCSS mund t'ju ndihmojë t'i dërgoni fletëthirrjen prindit kujdestar.

Ju mund të kërkonte modifikim nëse për çështjen tuaj vlen ndonjë nga sa më poshtë:

- Kanë kaluar tre vite që kur urdhri ka hyrë në fuqi, është modifikuar ose ndryshuar për herë të fundit.
- Ka pasur një ndryshim në të ardhurat bruto me 15% ose më shumë që nga koha që urdhri ka hyrë në fuqi, modifikuar ose ndryshuar për herë të fundit. Çdo rënie e të ardhurave duhet të jetë jovullnetare dhe prindi që pretendon rënie të të ardhurave duhet të jetë përpjekur të gjejë punë në përshtatje me arsimin, aftësitë dhe përvojën e tij/e saj.
- Individët e burgosur mund të paraqesin një kërkesë modifikimi për shkak të një ndryshimi thelbësor të rrethanave, për sa kohë që burgosja e tyre nuk është për shkak të mospagesës së mbështetjes financiare për fëmijën ose shkeljeje ndaj prindit kujdestar ose fëmijës. (kjo vlen vetëm për urdhrat e lëshuar pas datës 10 tetor 2010.)

Kur fëmija më i madh mbush 21 vjeç

- Nëse ka më shumë se një fëmijë të përfshirë në të njëjtin urdher për mbështetje financiare për fëmijën, shumica e detyrimit mund të jetë e ndarë. Kjo do të thotë që çdo fëmijë në ngarkim i caktohet një shumë specifike. Kur fëmija më i madh të mbushë 21 vjeç, OCSS do të zbrisë automatikisht në urdhrin e mbështetjes financiare shumë që i ishte caktuar atij fëmije.
- Nëse urdhri nuk e ka shumën e ndarë, prindi jokujdestar duhet të paraqesë një kërkesë në gjykatë për modifikim për zbritje kur fëmija më i madh të mbushë 21 vjeç. Në të kundërt, urdhri nuk do të ndryshojë dhe ju duhet të vazhdoni të paguani shumën e plotë duke përfshirë shumën për fëmijën që ka arritur moshën për t'u shkëputur nga trangu familjar.
- Nëse urdhri është lëshuar jashtë shtetit të Nju-Jorkut, data e arritjes së moshës për t'u shkëputur nga trangu familjar mund të mos jetë 21 vjeç.

Çfarë ndodh në seancën gjyqësore për një modifikim

- Pasi të paraqitni një kërkesë për modifikim në Gjykatën për Çështjet Familjare, do të caktohet një seancë gjyqësore. Do të keni një mundësi të paraqitni të ardhurat dhe shpenzimet tuaja aktuale.
- Magjistrati mbështetës do të shqyrtojë informacionin në përputhje me udhëzimet e Ligjit të Shtetit të Nju-Jorkut për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën dhe do të vendosë nëse urdhri duhet të ndryshohet.
- Çdo ndryshim në shumën e urdhrin do t'i referohet në kohë vetëm datës kur është paraqitur kërkesa në gjykatë, jo datës kur kanë ndryshuar rrethanat.

Rakordimi i kostos së jetesës

- OCSS mund të rrisë shumën në një urdher për mbështetje financiare për fëmijën me një rakordim të kostos së jetesës (COLA) kur çështja bëhet e pranueshme, pa shkuar në gjykatë.
- COLA bazohet në ndryshimet vjetore në Indeksin e Çmimeve të Konsumit për të gjithë Konsumatorët Urbanë (CPI-U), i cili ndjek çmimet e artikujve si: ushqimi, veshmbathja, banesa, transporti, karburanti dhe shpenzimet mjekësore.
- COLA mund t'i shtohet një urdhri mbështetjeje financiare për fëmijën kur rritjet vjetore të CPI-U-së shtohen deri në të paktën 10% nga data e krijimit ose modifikimit të fundit të urdhrin.
- Ju do të njoftoheni përpara se COLA t'i shtohet urdhrin tuaj dhe do të keni mundësinë ta kundërshtoni atë.
- Nëse kundërshtoni COLA-n, do të caktohet një seancë për modifikim në Gjykatën për Çështjet Familjare për të shqyrtuar shumën në urdhrin tuaj. Magjistrati mbështetës do të vendosë nëse urdhri duhet të ndryshohet ose të mbetet i njëjtë, bazuar në udhëzimet e Ligjit të Shtetit të Nju-Jorkut për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën.

PROGRAMET E REDUKTIMIT TË BORXHIT PËR PRINDËRIT JOKUJDESTARË

OCSS ka programe që mund të reduktojnë borxhin për mbështetje financiare për fëmijën (detyrimet e prapambetura) që i detyroheni Departamentit të Shërbimeve Sociale të qytetit të Nju-Jorkut (DSS). Nëse nuk jeni të sigurt nëse keni detyrime ndaj DSS-së, kontaktoni OCSS në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us.

TAVANI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA mund të reduktojë borxhin e akumuluar të mbështetjes financiare për fëmijën që i detyroheni qeverisë (DSS) në shumën \$500, pa shkuar në Gjykatën për Çështjet Familjare.

PËR T'U KUALIFIKUAR:

- Duhet të keni detyrime të prapambetura ndaj NYC DSS; nuk kërkohet të ketë ndonjë urdhër tarifimi ose urdhër aktiv për mbështetje financiare për fëmijën.
- Detyrimet e prapambetura duhet të jenë shtuar ndërkohë që të ardhurat kanë qenë nën nivelin federal të varfërisë (shihni <https://aspe.hhs.gov/topics/poverty-economic-mobility/poverty-guidelines>). Nëse nuk keni prova të të ardhurave të kaluara (deklarata tatimore, listëpagesa), kërkoni një vërtetim page nga Administrata e Sigurimeve Shoqërore ose vërtetim burgimi ose vërtetim të marrjes së një përfitimi (p.sh. ndihmë ekonomike).

PROGRAMI I KREDITIT TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA

(ARREARS CREDIT PROGRAM, ACP) mund të reduktojë shumën e detyrimeve të prapambetura ndaj DSS me \$5,000 në vit për deri në tre vjet, pa e dërguar çështjen në gjykatë. Si prindërit jokujeदारë që kanë urdhra aktualë për mbështetje financiare për fëmijën, ashtu edhe ata që kanë vetëm detyrime të prapambetura kanë të drejtë të marrin pjesë në ACP. Urdhrat aktualë mund t'i paguhen ose DSS-së, ose prindit kujdestar, por reduktimi do të aplikohet vetëm për detyrimet e prapambetura që i detyrohen DSS-së.

PËR T'U KUALIFIKUAR:

- Nuk ka kritere për të ardhurat për t'u kualifikuar për ACP.
- Bëni pagesa të plota çdo muaj për një vit të plotë.
- Prindërit e kualifikuar jokujeदारë do të marrin një kredit prej \$5,000 në vit, deri në tre vjet, për detyrimet e prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën që i detyrohen DSS-së.

PROGRAMI I SUKSESIT TË PRINDËRVE (PARENT SUCCESS PROGRAM)

nxit prindërit jokujeदारë të ndërmarrin hapa për të përmirësuar jetën e tyre, në mënyrë që të mund të bëjnë më shumë për fëmijët e tyre. Programi i Suksesit të Prindërve është për prindërit që kanë detyrime ndaj DSS-së të Nju-Jorkut. Ju mund të ulni borxhin tuaj ndaj NYC DSS deri në \$7,500 duke sjellë një vërtetim se keni përfunduar një program kualifikues për trajtimin e drogës.

PAY IT OFF është një program me kohë të kufizuar që u mundëson prindërve jokujeदारë t'ia paguajnë dy herë më shpejt borxhin e mbështetje financiare për fëmijën DSS-së së Nju-Jorkut. Kur paguani shumën minimale të kërkuar, OCSS do të reduktojë borxhin tuaj ndaj DSS-së në vlerën e dyfishit të pagesës, ose deri në shumën totale të detyrimeve të prapambetura për mbështetje financiare për fëmijën që i detyroheni DSS-së.

Për të zbuluar nëse kualifikoheni për një ose më shumë nga këto programe të reduktimit të borxhit, na dërgoni email në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us ose vizitoni një nga zyrat tona (shihni <https://on.nyc.gov/contactocss>).

Mësoni më shumë rreth programeve të reduktimit të borxhit të ofruara nga OCSS duke vizituar nyc.gov/ocss-debt-reduction. Përdorni aplikacionin në celular NYC Child Support – ACCESS HRA për të paraqitur një aplikim për një program reduktimi të borxhit: nyc.gov/childsupportmobile.



VONESAT ME PAGESAT

OCSS ndjek shumën që paguhet si mbështetje financiare për fëmijën dhe shumën që mbetet detyrim i pashlyer. Është detyra jonë të kujdesemi që pagesat të merren rregullisht dhe në kohë. Nëse keni vonesa me pagesat e mbështetje financiare për fëmijën tuaj, mund të zbatohen një sërë rrimesh administrative të ekzekutimit të detyrueshëm.

- Përpara se të ndërmerret ndonjë veprim i ekzekutimit të detyrueshëm, do t'ju dërgohet një njoftim me postë që shpjegon se si të parandaloni marrjen e kësaj mase dhe si të paraqitni një kundërshtim ose gabim fakti. Mund të hyni në youtube.com/hranyc për të parë një video se si të paraqitni një kundërshtim.
- Për më shumë informacion rreth çdo veprimi të ekzekutimit të detyrueshëm dhe si t'i kundërshtoni ato, shihni https://childsupport.ny.gov/dcse/enf_actions.html.
- Përdorni aplikacionin në celular NYC Child Support – ACCESS HRA për të plotësuar një formular ku kundërshtoni veprimin e ekzekutimit të detyrueshëm nyc.gov/childsupportmobile.
- Nëse jeni duke marrë ndihmë ekonomike ose Sigurime Shoqërore (SSI), nuk do të jeni objekt i disa veprimeve të ekzekutimit të detyrueshëm.
- Një çështje mund të jetë objekt i veprimeve të shumta të ekzekutimit të detyrueshëm në të njëjtën kohë.
- OCSS ka autoritetin të ekzekutojë urdhrat për mbështetje financiare për fëmijën me anë të proceseve administrative pa e ridërguar çështjen në gjykatë.
- Nëse këto metoda nuk rezultojnë në pagesa për mbështetje financiare për fëmijën, çështja mund t'i referohet Gjykatës për Çështjet Familjare për veprime gjyqësore të ekzekutimit të detyrueshëm.

Veprimet e automatizuara administrative të ekzekutimit të detyrueshëm

SHUMA E SHTUAR

Pagesat e mbështetje financiare për fëmijën mund të rriten përkohësisht me 50% mbi shumën e rregullt të urdhrit sa herë që ka vonesa me pagesat. Me një urdhër të ri, kjo mund të ndodhë menjëherë, sepse mbështetja financiare për fëmijën do t'i referohet në kohë vetëm datës kur është paraqitur kërkesa në gjykatë, jo datës së seancës.

KOMPENSIM ME ANË TË RIMBURSIMIT TË TAKSAVE

Nëse prisni një rimbursim federal ose shtetëror të tatimit mbi të ardhurat, ai mund t'i dërgohet OCSS-së dhe jo juve për të shlyer shumën e prapambetur të mbështetjes financiare për fëmijën.

- Kompensimi i shtetit të Nju-Jorkut me anë të rimbursimit të taksave do të bëhet nëse i detyroheni të paktën \$50.
- Kompensimi federal me anë të rimbursimit të taksave do të bëhet sapo të paguhen të paktën tre muaj nga pagesat e vonuara dhe shuma e borxhit të arrijë vlerën \$500 (\$150 nëse detyrimi duhet shlyer ndaj DSS-së).
- Shuma e kompensimit tatimor vendoset në vitin para marrjes së rimbursimit. Nëse nuk keni më detyrime financiare deri në momentin e marrjes së rimbursimit të taksave, do t'ju lëshohet një rimbursim sapo OCSS të marrë paratë nga IRS-ja ose Departamenti i Tatimeve dhe Financës të shtetit të Nju-Jorkut. Kjo mund të zgjasë gjashtë deri në tetë javë nga koha kur njoftoheni se rimbursimi i taksave po dërgohet në OCSS.
- Nëse është paraqitur një deklaratë e përbashkët tatimore, bashkëshorti pa përgjegjësi financiare ndaj fëmijës mund të paraqesë një formular të bashkëshortit të dëmtuar pranë IRS dhe/ose Departamentit të Tatimeve dhe Financës të shtetit të Nju-Jorkut për të kërkuar pjesën e tij ose të saj të rimbursimit. OCSS do të mbajë rimbursimin e IRS-së për 6 muaj për t'i dhënë bashkëshortit të dëmtuar një mundësi për të paraqitur një kërkesë për një pjesë të rimbursimit të taksave. Pas 6 muajsh, i gjithë rimbursimi do të kreditohet në llogarinë e prindit jokujdestar.

PENGIM I FITIMEVE TË LOTARISË

Nëse fitoni \$600 ose më shumë në lotarinë e shtetit të Nju-Jorkut dhe keni të paktën \$50 pagesa të prapambetura për mbështetje financiare për fëmijën, paratë e lotarisë mund t'i paguhen OCSS-së. Prindërit që kanë detyrim për mbështetje financiare për fëmijën do të informohen kur të shkojnë të mbrëqin çmimin nëse një pjesë apo i gjithi do të mbahet për të shlyer pagesat e prapambetura për mbështetje financiare për fëmijën. Më pas do të dërgohet me postë një letër zyrtare.

SEKUESTRIMI I LLOGARISË BANKARE (I NJOHUR SI KONFISKIMI I PRONËS [PEXI])

Llogaritë tuaja bankare (kursimet, çequet, tregu i parasë, Certifikata e Depozitës, IRA) dhe aktivet e tjera financiare mund të ngrijnë dhe sekuestrohen për të paguar OCSS-në nëse i detyroheni të paktën dy muaj mbështetje financiare aktuale për fëmijën dhe keni detyrime të prapambetura prej të paktën \$300.

- Nëse po paguani mbështetje financiare aktuale për fëmijën nëpërmjet zbritjeve automatike të të ardhurave, llogaria juaj bankare do të ngrijë nëse gjendja është \$3,000 ose më shumë.
- Nëse nuk po paguani mbështetje financiare aktuale për fëmijën përmes zbritjeve automatike të të ardhurave, llogaria juaj bankare do të ngrijë nëse gjendja është të paktën \$25.

- Nëse fondet në llogarinë tuaj bankare vijnë nga Sigurimet Shoqërore (SSI), ndihma ekonomike, pensioni i invaliditetit prej Administratës së Veteranëve nga shërbimi ushtarak, mbështetja financiare për fëmijën ose ndihma ushqimore, ato nuk mund të sekuestrohen nga OCSS.
- Në rastin e një llogarie të përbashkët bankare, disa banka do të lëshojnë të gjitha fondet e kërkuara nga OCSS. Banka të tjera mund të kërkojnë një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët për të liruar gjysmën e bilancit të llogarisë për detyrimet e prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën.

PEZULLIMI I LEJES SË DREJTIMIT TË AUTOMJETIT

Lejet e drejtimit të automjetit pezullohen nëse shuma e borxhit për mbështetje financiare për fëmijën është e barabartë ose më e madhe se shuma e katër muajve të urdhrit aktual të mbështetjes financiare për fëmijën dhe pagesat nuk po ekzekutohen nga zbritjet e pagës. Prindërit jokujdestarë që marrin Sigurime Shoqërore (SSI) ose ndihmë ekonomike, përjashtohen nga pezullimi i lejes së drejtimit të automjetit. Nëse merrni një njoftim se leja juaj do të pezullohet, mund ta parandaloni duke bërë njërin prej veprimeve më poshtë:

- Të paguani gjithë detyrimin.
- Të jepni informacionin e punësimit në mënyrë që punëdhënësi juaj të mbajë pagesat direkt nga paga juaj.
- Të bëni një marrëveshje pagese me OCSS-në për të paguar shumën e urdhëruar nga gjykata plus një 50% shtesë ndaj detyrimeve të prapambetura.
- Të vërtetoni se të ardhurat tuaja janë nën rezervën e vetëmbështetjes financiare së shtetit të Nju-Jorkut: <https://www.childsupport.ny.gov/dcse/pdfs/CSSA.pdf>.
- Nëse ndodh pezullimi, mund të kërkonit një leje drejtimi të kufizuar nga Departamenti i Mjeteve Motorike që ju lejon të shkoni dhe të ktheheni nga puna.

DENONCIMI TE BYROJA E KREDITIT

Emrat e prindërve që nuk kanë kujdestari u dërgohen Agjencive kryesore të Raportimit të Konsumatorit kur ata kanë një borxh të paktën \$1,000 të mbështetjes financiare për fëmijën ose kanë dy muaj pa shlyer pagesat, cilado që të ndodhë e para. Ky denoncim do të lërë një njollë në raportin e kredit të prindit, duke e bërë të vështirë ose më të kushtueshme marrjen e një karte krediti, kredie hipotekore, ose lloje të tjera kredie.

REFERIMI TE DEPARTAMENTI I TATIMEVE DHE FINANCËS TË SHETIT TË NJU-JORKUT

Çështjet i referohen Departamentit të Tatimeve dhe Financës të Shtetit të Nju-Jorkut për identifikimin dhe sekuestrimin e pasurive nëse shuma e borxhit është më e madhe se shuma e katër muajve të urdhrit aktual të mbështetjes financiare për fëmijën, është të paktën \$500 dhe nuk janë marrë pagesa për mbështetje financiare për fëmijën në 45 ditët e fundit nga zbritjet e pagës. Prindërit jokujdestarë që marrin SSI ose ndihmë ekonomike janë të përjashtuar nga ky proces.

REFUZIMI I MARRJES OSE RINOVIMIT TË PASAPORTAVE

Prindërit jokujdestarë njoftohen paraprakisht se borxhi i tyre për mbështetje financiare për fëmijën po i raportohet Departamentit të Shtetit të SHBA-së (U.S. Department of State) (një agjenci federale). Departamenti i Shtetit do të refuzojë kërkesën për pasaportë të re ose rinovim të saj nëse detyrimi i mbështetjes financiare për fëmijën është të paktën \$2,500. Pasaporta nuk do të lëshohet derisa borxhi i mbështetjes financiare për fëmijën të zgjidhet me OCSS-në.

REFUZIM OSE DHËNIE E PËRKOHSHME E LICENCAVE PROFESIONALE NË QYTETIN E NJU-JORKUT

Aplikimet për licenca profesionale të reja dhe rinovim të tyre në qytetin e Nju-Jorkut do të refuzohen, ose do të jepet një licencë e përkohshme gjashtëmuajore, nëse aplikanti ka një detyrim për mbështetje financiare për fëmijë të barabartë me të paktën katër muaj mbështetje financiare aktuale për fëmijën. Shembuj të agjencive të licencimit të qytetit të Nju-Jorkut përfshijnë:

- Departamenti i Çështjeve të Konsumatorit (Department of Consumer Affairs)
- Komisioni i Taksive dhe Limuzinave (Taxi and Limousine Commission)
- Departamenti i Zjarrfikësve (Fire Department)
- Departamenti i Policisë së Nju-Jorkut (New York Police Department)

Aplikantët mund të paguajnë detyrimin ose të lidhin një marrëveshje me OCSS-në për të miratuar aplikimet e tyre për licencë. Nëse keni probleme me marrjen e një licence profesionale në qytetin e Nju-Jorkut për shkak të një borxhi të papaguar për mbështetje financiare për fëmijën:

- Vizitoni Qendrën Fizike të OCSS -së për Shërbimin e Klientit në adresën 151 West Broadway ndërmjet orës 8:00 dhe 18:00, nga e hëna në të premte (përveç ditëve të festave zyrtare), ose
- Dërgoni email në OCSS në adresën dcse.cseweb@dca.state.ny.us për të kërkuar një takim nëpërmjet telefonit dhe për të përfshirë emrin, numrin e çështjes, numrin e telefonit dhe oraret kur preferoni të kontaktoheni.

Veprimet gjyqësore të ekzekutimit të detyrueshëm/Kërkesë për shkelje

KËRKESA PËR SHKELJE

Kur metodat administrative të zbatimit të detyrueshëm nuk rezultojnë në arkëtimin e mbështetjes financiare për fëmijën, nga prindi kujdestar ose OCSS (për prindërit jokujdestarë që i kanë borxh DSS-së mbështetjen financiare për fëmijën) mund të paraqitet një kërkesë për shkelje në Gjykatën për Çështjet Familjare. Një seancë gjyqësore për shkelje do të rezultojë në:

- **SHUMË PARASH TË PËRCAKTUAR NGA GJYKATA:** Pagesat e prapambetura të mbështetjes financiare për FËMIJËN fiksohen nga gjykata me një shumë të caktuar që grumbullon 9% interes çdo vit derisa të shlyhet.

Përveç kësaj, seanca mund të rezultojë në:

- **NGRIRJA TË PRONËS:** Në pronën e prindit jokujdestar mund të vendoset një barrë siguroese me kushtin që të paguhet borxhi i mbështetje financiare për fëmijën përpara se prona të shitet ose transferohet.
- **DEPOZITA CASH:** Prindit jokujdestar mund t'i kërkohet të depozitojë para (me vlerën e tre viteve pagesa) për mbështetjen financiare të ardhshme për fëmijën. Pagesat mund të merren nga kjo depozitë nëse prindi jokujdestar nuk e paguan rregullisht mbështetjen. Quhet gjithashtu obligacion ekonomik ose angazhim në para.
- **ARRESTIM/BURGOSJE:** Gjykata mund të lëshojë një urdhër arresti nëse prindi jokujdestar nuk paraqitet në gjykatë për një seancë për shkelje. Në disa raste të mospagesës me dashje të mbështetje financiare për fëmijën, prindi jokujdestar mund të burgoset deri në gjashtë muaj. Mospagesa me dashje do të thotë që prindi jokujdestar mund të përballojë të paguajë mbështetje financiare për fëmijën, por zgjedh të mos paguajë, ose shmang qëllimisht të punësohet, ose transferon para për të shmangur pagesën.
- **PEZULLIMI I LICENCAVE PROFESIONALE TË LËSHUARA NGA SHTETI, TË BIZNESIT DHE ATYRE PROFESIONALE:** Gjykata për Çështjet Familjare mund t'i rekomandojë bordit përkatës të licencimit që prindërve jokujdestarë, të cilët kanë një borxh të mbështetjes financiareje për fëmijën të barabartë me ose më shumë se katër muaj mbështetje aktuale, t'u pezullohen licencat e lëshuara nga shteti. Shembuj të profesioneve që duhet të regjistrohen ose licencohen nga shteti i Nju-Jorkut përfshijnë berberët, fizioterapistët, avokatët dhe mjekët.

PJESËMARRJE NË PROGRAMIN E MBËSHTETJES SË PRINDËRVE (PSP)

Kur një prind jokujdestar është i papunë ose ka një punë me pagë të ulët, ose nuk punon aq orë sa të paguajë mbështetjen financiare për fëmijën, magjistrati mbështetës mund ta urdhërojë të marrë pjesë në PSP që i ndihmon prindërit jokujdestarë të gjejnë punë në mënyrë që të paguajnë mbështetje financiare për fëmijën ose mund ta referojë te Departamenti i Shërbimit të Provës (DOP).

REFERIM PËR NDJEKJE PENALE

OCSS mund të kërkojë ndjekjen penale të një prindi jokujdestar nga Zyra e Prokurorit të SHBA-së ose Zyra e Prokurorit lokal të Kontesë, kur është vërtetuar mospagesa e qëllimshme e mbështetjes financiare për fëmijën, kur ka detyrime të konsiderueshme të prapambetura dhe kur veprimet e tjera të ekzekutimit të detyrueshëm kanë dështuar.



SHFUQIZIMI I URDRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Në shtetin e Nju-Jorkut, ju duhet të paguani mbështetje financiare për fëmijën derisa fëmija të shkëputet nga trangu familjar, zakonisht kur të mbushë moshën 21 vjeç, përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe. Urdhrat mund të zgjaten pas moshës 21 vjeç për arsye arsimore ose mjekësore. Një urdhër mund të shfuqizohet nga Gjykata për Çështjet Familjare përpara se fëmija të mbushë moshën 21 vjeç nëse ndodh ndonjë nga të mëposhtmet:

- Fëmija shkëputet nga trangu familjar. Fëmija shkëputet nga trangu familjar – largohet nga shtëpia dhe është i aftë të mbajë veten, të martohet, ose hyn në ushtri.
- Ju merrni kujdestarinë e fëmijës. Në këtë rast, mund të lëshohet urdhri që prindi tjetër t'ju paguajë mbështetje financiare për fëmijën.
- Ju shpërnguleni dhe krijoni një familje me prindin dhe fëmijën kujdestar.

Pasi të shfuqizohet urdhri aktual, mund të keni ende detyrime ndaj prindit kujdestar ose Departamentit të Shërbimeve Sociale për mbështetje financiare për fëmijën nëse nuk u jeni përmbajtur afateve të pagesave dhe keni detyrime të prapambetura. Pagesat duhet të vazhdojnë derisa të shlyhet borxhi për mbështetje financiare për fëmijën.



INFORMACION PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR FËMIJËN/NDIHMËN PËR ÇËSHTJEN

Nëse keni pyetje rreth programit të mbështetjes financiare për fëmijën, keni nevojë për ndihmë me çështjen tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën ose duhet t'i jepni informacion shtesë OCSS-së si p.sh. ndryshimi i vendit të punës ose i adresës:



Dërgojini një email Shërbimit ndaj Klientit të Zyrës së HRA-së për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us.

Përfshini emrin tuaj të plotë, ID-në e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën dhe datëlindjen. Vendosni një frazë përshkruese të subjekti dhe jepni detaje në emailin tuaj, në mënyrë që stafi t'ju japë një përgjigje të detajuar.



Për të lënë një takim nëpërmjet telefonit me një përfaqësues të Shërbimit ndaj Klientit, na dërgoni email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us.

Jepni emrin tuaj të plotë, numrin e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën, datëlindjen, një përshkrim të shqetësimit (-ve), numrin e telefonit dhe orarin kur preferoni t'ju kontaktojmë. Përdorni subjektin "Kërkesë për takim me Shërbimin ndaj Klientit" në emailin tuaj. Kërkesat e takimeve telefonike do të marrin përgjigje brenda 3 ditësh pune.



Vizitoni Qendrën Fizike të OCSS-së së HRA-së për Shërbimin e Klientit ose një Gjykatë për Çështjet Familjare. Vendndodhjet mund të gjenden në adresën <https://on.nyc.gov/contactocss>.



Vizitoni faqen e internetit të OCSS-së së HRA-së në adresën <https://nyc.gov/hra/ocss> për të mësuar më shumë rreth shërbimeve të mbështetjes financiare për fëmijën.



Telefononi Linjën Telefonike të Ndihmës të Shtetit të Nju-Jorkut për Mbështetjen Financiare për Fëmijën **888-208-4485**.



Dërgojini korrespondencat postare në adresën:
OCSS
PO Box 830
Canal Street Station
New York, NY 10013

Burimet në internet

Zyra për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut (OCSS)
nyc.gov/hra/ocss

Shikoni video të mbështetjes financiare për fëmijën
youtube.com/hranyc

Zyra e Fuqizimit Financiar e qytetit të Nju-Jorkut (New York City Office of Financial Empowerment)
Këshillim dhe edukim financiar pa pagesë
nyc.gov/ofe

Spektori për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në shtetin e Nju-Jorkut (New York State Division of Child Support Services),
Shikoni informacionin e llogarisë tuaj*
childsupport.ny.gov

Sistemi i Unifikuar i Gjykatave në shtetin e Nju-Jorkut (New York State Unified Court System)
nycourts.gov

Aplikacioni celular për mbështetjen financiare për fëmijën NYC Access HRA
<http://www.nyc.gov/childsupportmobile>

FORMULARI I NJOHJES SË ATËSISË/ MËMËSISË

LDSS-5171 (Rev. 04/21)

FORMULARI I NJOHJES SË ATËSISË/MËMËSISË

(Ju lutemi shkruani me shkronja shtypi ose shkronja të mëdha të qarta me bojë të zezë.)

Konteja e regjistruar _____ Kodi i spitalit _____ Numri i regjistrit _____

Shënoni kutinë: Spitali Zyra e Programit për Mbeshtetje Financiare për Fëmijën Regjistruar i lindjes Tjetër

Fëmijë

Emri _____ Emri i dytë _____ Mbiemri _____

Gjinia _____ Datëlindja (MM/DD/YYYY) _____

Femër Mashkull Jobinar/tjetër

Spitali i lindjes _____ Qyteti i lindjes _____ Qarku/lagjja i lindjes _____

Nëse është dorëzuar tashmë certifikata e lindjes së fëmijës, por ju dëshironi t'i ndryshoni mbiemrin fëmijës, plotësoni seksionin e mëposhtëm:

Mbiemri në certifikatën origjinale të lindjes _____ Mbiemri i ri _____

Ne e kuptojmë se nënshkrimi i këtij dokumenti të Njohjes së Atësisë/Mëmësisë është vullnetar dhe do të përcaktojë atësinë/mëmësinë e fëmijës tonë me të njëjtën fuqi dhe efekt si Urdhri i Njohjes së Atësisë/Mëmësisë që lëshohet pas një seance gjyqësore ku përshihet detyrimi i mbështetjes financiare për fëmijën tonë. Vetëm nëse ky dokument i njohjes së atësisë/mëmësisë dorëzohet në zyrën e gjendjes civile ku është depozituar certifikata e lindjes, ai do të ketë fuqi dhe efekt në lidhje me të drejtat e trashëgimisë. Ne jemi njoftuar me shkrim dhe me gojë për të drejtat tona ligjore (përfshirë afatet kohore për t'u tërhequr), përgjegjësitë, alternativat dhe pasojat e nënshkrimit të njohjes së atësisë/mëmësisë dhe ne e kuptojmë se çfarë thotë njoftimi. Na është dhënë një kopje e njoftimit me shkrim. Ne vërtetojmë se informacioni që japim më poshtë është i vërtetë.

Prindi biologjik

Emri _____ Emri i dytë _____ Mbiemri _____

Adresa _____ Kati/Apt. _____ Qyteti _____ Shteti _____ ZIP _____

Datëlindja (MM/DD/YYYY) _____ Numri i sigurimeve shoqërore _____ Ishit e martuar në momentin e lindjes? Po Jo

Përmes këtij dokumenti, unë pranoj njohjen e atësisë për fëmijën tim të shënuar më lart dhe pranoj se personi i shënuar më poshtë është i vetmi prind tjetër gjenetik i mundshëm, ose është një prind i synuar dhe fëmija është ngjizur nëpërmjet riprodhimit të asistuar.

Nënshkrimi _____ Data (MM/DD/YYYY) _____

Seksioni i dëshmitarit (Kërkojen dy dëshmitarë; dëshmitarët nuk mund të jenë të afërmit me asnjërin nga prindërit) _____ Nënshkrimi i dëshmitarit _____ Emri me shkronja shtypi i dëshmitarit _____ Data (MM/DD/YYYY) _____

Nënshkrimi i dëshmitarit _____ Emri me shkronja shtypi i dëshmitarit _____ Data (MM/DD/YYYY) _____

Prindi tjetër

Emri _____ Emri i dytë _____ Mbiemri _____

Adresa _____ Kati/Apt. _____ Qyteti _____ Shteti _____ ZIP _____

Qyteti i lindjes _____ Shteti/Provinca e lindjes _____ Vendi i lindjes _____

Datëlindja (MM/DD/YYYY) _____ Numri i sigurimeve shoqërore _____ Jeni babai gjenetik/biologjik i fëmijës? Po Jo

Përmes këtij dokumenti unë pranoj se jam prind i gjenetik ose i synuar i fëmijës së shënuar më lart.

Nënshkrimi _____ Data (MM/DD/YYYY) _____

Seksioni i dëshmitarit (Kërkojen dy dëshmitarë; dëshmitarët nuk mund të jenë të afërmit me asnjërin nga prindërit) _____ Nënshkrimi i dëshmitarit _____ Emri me shkronja shtypi i dëshmitarit _____ Data (MM/DD/YYYY) _____

Nënshkrimi i dëshmitarit _____ Emri me shkronja shtypi i dëshmitarit _____ Data (MM/DD/YYYY) _____

For Official Use Only

The above Acknowledgment of Parentage is hereby filed with the _____ registrar on _____

If this document is to amend a birth certificate, I certify that I have examined the original record this seeks to amend and the information on this document matches. There are no omissions or apparent errors that render it unacceptable for amending the birth record. This document is therefore approved.

State Registrar/Deputy City Registrar signature _____ Date (MM/DD/YYYY) _____

LDSS-5171 (Rev. 04/21)

New York State Office of Temporary and Disability Assistance
New York State Department of Health
Pursuant to Section 4135-b of Public Health Law

Prindi biologjik

Emri _____

Adresa _____

Kati/Apt. _____ Qyteti _____ Shteti _____ ZIP _____

Adresa postare e prindit biologjik duhet të shkruhet këtu me shkronja të mëdha

Prindi tjetër

Emri _____

Adresa _____

Kati/Apt. _____ Qyteti _____ Shteti _____ ZIP _____

Adresa postare e prindit tjetër duhet të shkruhet këtu me shkronja të mëdha

Dhuruesi i gametëve (nëse është e aplikueshme)

Emri _____

Adresa _____

Kati/Apt. _____ Qyteti _____ Shteti _____ ZIP _____

Adresa postare e dhuruesit të gametëve, nëse dihet, duhet të shkruhet këtu me shkronja të mëdha

SHABLLON I URDHRIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

Çështja numër: F-XXXX-XX
4-7

PJESA
A

F.C.A. §§ 413, 416, 433, 438,
439, 440, 442-447, 471; Neni 5-B,

Ligjet për
Gjykatën e
Çështjeve
Familjare që
regullojnë
seancën
gjyqësore

4-7 11/2002 Numri i formularit dhe data e lëshimit

Në një mandat të Gjykatës së Çështjeve
Familjare të shtetit të Nju-Jorkut, mbajtur
në dhe për Oarkun e Richmond, në 100
Richmond Terrace, Staten Island, NY
10301, më 4 tetor 2004.

Adresa e
gjykatës dhe
data e seancës

PJESA
B

TË PRANISHËM Magjistrati mbështetës
i Gjykatës së Çështjeve Familjare
Për çështjen e një procesi mbështetës

Dozja #: XXXXX
Numri i çështjes #: F-XXXX-XX
CSMS #: XXXXXXXXX

Çështje e mbështetjes
financiare për fëmijën
dhe informacion i
identifikimit në gjykatë

URDHËR MBËSHTETJE

Lloji i urdhrit

Palët e përfshira

SSN-ja e prindit kujdestar: XXX-XX-XXXX,
Paditësi,

– kundër –

SSN-ja e prindit jokujdestar: XXX-XX-XXXX,
I padituri.

Vazhdim i
PJESËS E

Emri Numri i sigurimeve shoqërore Datëlindja Shuma
Fëmijë
Fëmija XX/XX/XXXX
Mbështetja financiare totale për fëmijën:

\$XX.XX në javë

URDHËROHET që paguesi, pala kujdestare dhe çdo palë tjetër individuale të njoftojnë menjëherë
Njësinë e Arkëtitimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare për çdo ndryshim në informacionin e
mëposhtëm: adresat e banimit dhe postare, numrin e sigurimeve shoqërore, numrin e telefonit,
numrin e lejes së drejtimit; dhe emrin, adresën dhe numrat e telefonit të punëdhënësve të palëve
dhe çdo ndryshim në përfitimet e sigurimit shëndetësor, duke përfshirë çdo ndërprerje të përfitimeve,
ndryshim në kompaninë ose shumën e paguar për sigurimin shëndetësor, ose në sasinë dhe
disponueshmërinë e përfitimeve ekzistuese ose të reja; gjithashtu

Njoftim për
të informuar
Agjencinë
për çdo
ndryshim në
vendbanimin,
punësimin
tuaj, etj

URDHËROHET që ky urdhër ekzekutohet në përputhje me nenin 5241 ose 5242 të Ligjit dhe
Regullave të Praktikës Civile, ose në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj; si dhe

URDHËROHET që prindi jokujdestar të paguajë shpenzimet shtesë si në vijim:

Shpenzimi/Paguesi	Pagesë	E pagueshme
Pa rimbursim shëndetësor/ Prindi kujdestar	XX %	Nëpërmjet SCU-së
Kujdesi për fëmijën	XX %	Direkt
Prindi kujdestar	XX %	Direkt

Shpenzime përveç shumës bazë të
mbështetjes financiare për fëmijën
• Mjekësore
• Kujdesi për fëmijën
• Arsimi

PJESA
C

KUJDES: MOSRESPEKTIMI I KËTIJ URDHRI NË MËNYRË TË QËLLIMSHME MUND TË REZULTOJË NË
BURGIM PËR MOSMBËSHTETJE OSE SHPËRFILLJE KRIMINALE. MOSRESPEKTIMI I KËTIJ URDHRI
MUND TË REZULTOJË NË PEZULLIM TË LEJES SUAJ TË DREJTIMIT, LICENCAVE PROFESIONALE TË
LËSHUARA NGA SHETIT, TË TREGTISË, BIZNESIT DHE ATYRE PROFESIONALE, SI DHE LICENCAVE
DHE LEJEVE REKREACIONALE DHE SPORTIVE DHE KONFISKIM TË PRONËS SË PATUNDSHME
DHE PERSONALE.

Paraqitja
e një
kundërshtimi

KUNDËRSHTIMET SPECIFIKE ME SHKRIM NDAJ KËTIJ URDHRI MUND TË DORËZOHEN NË
GJYKATË BRENDA 30 DITËSH NGA DATA E MARRJES SË URDHRI NË GJYKATË OSE ME ANË TË
SHËRBIMIT PERSONAL, OSE BRENDA 35 DITËSH NGA DATA E DËRGIMIT NËSE URDHRI ËSHTË
DËRGUAR ME POSTË.

Paditësi i lartpërmendur ka paraqitur një kërkesë në këtë Gjykatë më 22 qershor 2004,
duke pretenduar se prindi jokujdestar duhet të paguajë mbështetje për:

Emri
Emri i fëmijës

Datëlindja
XX/XX/XXXX

Prindi jokujdestar, pasi është këshilluar nga gjykata për të drejtën për avokat, është paraqitur para
kësaj gjykate për t'iu përgjigjur kërkesës dhe për të treguar se përse nuk duhet të jepet një urdhër
mbështetjeje dhe lehtësime të tjera të përfshira në kërkesë; dhe Prindi jokujdestar ka pranuar
pretendimet e kërkesës; dhe çështja ka ardhur për shqyrtim në këtë gjykatë:

TANI, pas shqyrtimit dhe hetimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes dhe pasi dëgjimit të provave
dhe dëshmive të ofruara në lidhje me të, gjykata konstaton se: Prindi jokujdestar është pala
jokujdestare, shuma javore përkatëse e detyrimit të mbështetjes financiare bazë e së cilës është
XX.XX\$ për fëmijën me të dhënat e mëposhtme:

Emri i fëmijës Datëlindja Numri i sigurimeve shoqërore #

Gjykata gjithashtu konstaton se: Shuma përkatëse e detyrimit të mbështetjes financiare bazë të
prindit jokujdestar nuk është as e padrejtë dhe as e papërshtatshme;

Pala jokujdestare momentalisht nuk është e punësuar;

TANI, pas shqyrtimit dhe hetimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes dhe pasi dëgjimit të provave
dhe dëshmive të ofruara në lidhje me të, Statusi i punësimit të prindit jokujdestar

Data e hyrjes në
fuqi të urdhrit
të mbështetjes
financiare për
fëmijën (Data
juaj do të jetë
e ndryshme)

URDHËROHET DHE VENDOSËT duke filluar nga data 28 janar 2005, prindi jokujdestar është
ngarkuar me detyrimin për të mbështetur personin e mëposhtëm dhe ka mjetet e mjaftueshme dhe
është në gjendje të fitojë këto mjete për t'iu paguar shumën \$XX.XX çdo javë Prindit jokujdestar me
çek të certifikuar ose urdhër pagese që i dorëzohen Njësisë për Marrjen e Mbështetjes, këto pagesa
duhet të fillojnë në datën 28 janar 2005, për fëmijët e prindit jokujdestar të ndara si në vijim:

Personi do të marrë pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën

Plotësoni kutinë që aplikohet për ju:

Urdhri është dërguar me postë më [specifikoni datën (-at)] dhe personin të cilit i është dërguar;

Urdhri është marrë në gjykatë më [specifikoni datën (-at)] dhe personat të cilëve u është dhënë;

PJESA
F

GJITHASHTU URDHËROHET që të gjitha pagesat që paguhën nëpërmjet Njësisë së Arkëtitimit
të Detyrimit të Mbështetjes Financiare duhet të dërgohen me postë te: Njësia për Marrjen
e Mbështetjes, Kutia postare 15363,
Albany, NY 12212- 5363;

Ku të dërgohen pagesat
derisa të vijë nëpërmjet
punës tuaj

SË FUNDI URDHËROHET që të jepet një kopje e këtij urdhri nga Njësia e Arkëtitimit të Detyrimit të
Mbështetjes Financiare për Regjistrin e Çështjeve të Urdhrave të Mbështetjes në Shtetin e Nju-Jorkut
të krijuar në zbatim të seksionit 111-b(4-a) të ligjit për Shërbimet Sociale; si dhe URDHËROHET që
ky është një urdhër mbështetjeje në shumën \$XX në javë nga data 8/10/04 derisa të rritet më 28/01/05.

Përmbledhje
e vendimeve
të gjykatës

PJESA
G

SHËNIM: (1) KY URDHËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR FËMIJËN DO TË NDRYSHOHET NËPËRMJET
APLIKIMIT TË RAKORDIMIT TË KOSTOS SË JETESËS NGA NJËSIA E ARKËTIMIT TË DETYRIMIT TË
MBËSHTETJES FINANCIARE JO MË PARË SE NJËZET E KATËR MUAJ PAS LËSHIMIT, MODIFIKIMIT OSE
RREGULLIMIT TË FUNDIT TË URDHRI, ME KËRKESË TË NJËRËS NGA PALËT ME URDHËR OSE SIPAS
PARAGRAFIT TË MËPOSHTËM (2). PAS APLIKIMIT TË RAKORDIMIT TË KOSTOS SË JETESËS ME UDHËZIM TË
NJËSISË PËR MARRJEN E MBËSHTETJES, DUHET TË DËRGOHET NJË KOPJE E URDHRI TË NDRYSHUAR
TE PALËT TË CILAT, NËSE KUNDËRSHTOJNË RAKORDIMIN E KOSTOS SË JETESËS, DO TË KENË 35 DITË
NGA DATA E DËRGIMIT ME POSTË PËR TË DORËZUAR NJË KUNDËRSHTIM ME SHKRIM NË GJYKATË PËR
KËTË URDHËR TË RAKORDUAR. PAS MARRJES SË KËTIJ KUNDËRSHTIMI ME SHKRIM, GJYKATA DUHET TË
PLANIFIKOJË NJË SEANCË GJYQËSORE NË TË CILËN PALËT MUND TË JENË TË PRANISHME PËR TË OFRUAR
PROVA QË DO TË MERRËN PARASYSH NGA GJYKATA PËR NDRYSHIMIN E URDHRI TË MBËSHTETJES
FINANCIARE PËR FËMIJËN NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJES.

Kostoja e
jetesës
Rakordime
(COLA)

(2) NJË MARRËS I NDIHMËS FAMILJARE DUHET TË RISHIKOJË DHE NDRYSHOJË URDHRI E MBËSHTETJES
PËR FËMIJËN NËN DREJTIMIN E NJËSISË SË ARKËTIMIT TË DETYRIMIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE JO
MË HERËT SE NJËZET E KATËR MUAJ PAS LËSHIMIT TË KËTIJ URDHRI, MODIFIKIMIT OSE RREGULLIMIT TË
TUJ TË FUNDIT PA APLIKIM TË MËTEJSHËM TË NDONJË PALE. TË GJITHA PALËT DO TË NJOFTOHEN PËR
RAKORDIMET.

(3) KUR NJËRA PALË NUK ËSHTË NË GJENDJE TË JAPË NJË ADRESË AKTUALE KU MUND TË DËRGOHET
URDHRI I NDRYSHUAR, DHE TË PËRDITËSOJË NDRYSHIMET, NË NJËSINË E ARKËTIMIT TË DETYRIMIT TË
MBËSHTETJES FINANCIARE, SIÇ KËRROHET NGA SEKSIONI 443 NË LIGJIN PËR GJYKATËN E ÇËSHTJEVE
FAMILJARE, SHUMA E DETYRIMIT TË MBËSHTETJES NË TË DUHET TË BËHET E DETYRUESHME NË DATËN
E AFATIT PËR PAGESËN E PARË SIPAS KUSHTEVE TË URDHRI PËR MBËSHTETJE TË RISHIKUAR DHE
NDRYSHUAR NË OSE PAS DATËS EFFEKTIVE TË URDHRI PAVARËSISHT NËSE PALA KA MARRË NJË KOPJE
TË URDHRI TË NDRYSHUAR OSE JO.

Datë: 4 Tetor, 2004

VENDOSNI

Magjistrati mbështetës i Gjykatës së Çështjeve Familjare

Plotësoni kutinë që aplikohet për ju:

Urdhri është dërguar me postë më [specifikoni datën (-at)] dhe personin të cilit i është dërguar;

Urdhri është marrë në gjykatë më [specifikoni datën (-at)] dhe personat të cilëve u është dhënë;

Emri dhe
vula e
magjistratit
mbështetës

FJALORTH PËR TERMAT E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR FËMIJËN

A

ANALIZË ADN-je: Analizë e faktorëve trashëgues që përcakton nëse një person i caktuar është babai i fëmijës; kampionet e ADN-së merren në pjesën e brendshme të faqes së babait, nënës dhe fëmijës duke përdorur një tampon të veçantë.

ANGAZHIM NË PARA: Si rezultat i një seance gjyqësore, një prind jokujdestar mund të urdhërohet t'i paguajë Njesisë së Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare në OCSS një angazhim në para në shumën e pagesës së mbështetjes financiare për fëmijën së deri tre viteve. Pagesat mund të merren nga kjo depozitë nëse prindi jokujdestar nuk e paguan rregullisht mbështetjen.

ARSYE E PRANUESHME PËR PËRJASHTIM: Arsyë ligjore për të cilën një aplikant ose marrës i ndihmës ekonomike përjashtohet nga detyrimi për të bashkëpunuar me mbështetjen financiare për fëmijën.

ATËSIA OSE PËRCAKTIMI I ATËSISË/MËMËSISË: Përcaktimi ligjor i atësisë. Përcaktimi i atësisë ose atësisë/mëmësisë duhet të bëhet përpara lëshimit të urdhrat të mbështetjes financiare ose mjekësore për fëmijën.

B

BABAI LIGJOR: Personi që njihet me ligj si prindi mashkull i fëmijës. Për t'u njohur si babai ligjor, duhet të përcaktohet atësia/mëmësia nëse prindërit nuk janë të martuar me njëri-tjetrin.

BARRA E PROVËS: Detyra e një pale për të paraqitur pjesën më të madhe të provave në një pikë apo çështje.

C

CAKTIMI I TË DREJTAVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE: Kërkesa për një marrëveshje nga personi që merr ndihmë ekonomike për të dorëzuar në shtet çdo pagesë për mbështetje financiare për fëmijën që ka marrë në këmbim të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera.

ÇËSHTJET NDËRSHTETËRORE: Çështjet kur fëmija i varur dhe prindi jokujdestar jetojnë në shtete të ndryshme dhe kur dy shtete përfshihen në aktivitete të çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën, si përcaktimi ose ekzekutimi i detyrueshëm.

COLA (Rakordimi i Kostos së Jetesës): Rritja e urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën, pa seancë gjyqësore. COLA bazohet në ndryshimet e Indeksit të Çmimeve të Konsumit për të gjithë Konsumatorët Urbanë (CPI-U), i cili shikon ndryshimet e shpenzimeve të jetesës së përditshme si ushqimi, veshjet, strehimi, etj.

CPI-U (Indeksi i Çmimeve të Konsumit për të gjithë Konsumatorët Urbanë): Gjurmon çmimet e artikujve për ushqime, veshmbathje, dhe strehim mbi baza vjetore. Rakordimet e kostos së jetesës (COLA) bazohen në ndryshimet vjetore të CPI-U-së.

D

DEKLARATA FINANCIARE: Dokument që u jepet të dyja palëve në një çështje të mbështetjes financiare për fëmijën, që kërkon informacion të detajuar financiar, të pagës dhe shpenzimeve; përdoret nga gjykata për të përcaktuar mbështetjen financiare për fëmijën, mbështetjen mjekësore, kujdesin ndaj fëmijëve dhe pjesë të tjera të urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën.

DEKLARATË: Deklaratë me shkrim e faktit e bërë në mënyrë të vullnetshme nën betim.

DETYRIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE BAZË PËR FËMIJËN: Shuma e mbështetjes financiare për fëmijën e bazuar në një përqindje fikse të të ardhurave të prindit, para se të shtohen mbështetja mjekësore dhe shpenzimet e kujdesit për fëmijën dhe/ose shpenzimet e arsimit.

DISBURSIMI: Paga e fondeve të mbledhura për mbështetjen financiare për fëmijën për prindërit kujdestarë ose për Departamentin e Shërbimeve Sociale nëse klienti merr ndihmë ekonomike.

E

EBT (Transferimi Elektronik i Përfitimeve): Metoda që përdor shteti i Nju-Jorkut për të dërguar paratë e Ndihmës së Përkohshme dhe të Invaliditetit (OTDA) dhe përfitimet e SNAP-it te marrësit. Përfitimet aksesohen duke përdorur një letërnjoftim dhe një PIN.

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM: Aplikimi i metodave për të marrë pagesat për një fëmijë ose detyrimet e mbështetjes mjekësore që përmban urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën. Disa mënyra janë sekuestrimi i aseteve, pezullimi i lejes së drejtimit, mosdhënia e pasaportës së SHBA-së, etj.

EMANCIPIM: Kur fëmija nuk jeton me prindërit e tij ose saj dhe ka një burim të ardhurash, është mobilizuar në ushtri ose është martuar.

F

FLETËTHIRRJE: Njoftim se është ndërmarrë një veprim kundrejt marrësit. Një fletëthirrje për një seancë gjyqësore për mbështetje financiare për fëmijën i tregon prindit kur dhe ku duhet të paraqitet dhe çfarë informacioni duhet të marrë me vete.

G

GJETJA: Procesi i gjetjes së prindit jokujdestar, me qëllim përcaktimin e atësisë/mëmësisë dhe përcaktimin dhe/ose ekzekutimin e detyrueshëm të mbështetjes financiare për fëmijën.

GJYKIM: Vendim zyrtarë ose konkluzion i një gjyqtari ose magjistrati

H

HEDHJE POSHTË ME TË DREJTË ANKIMIMI: Faktet e një kërkesë kanë rezultuar të pabaza dhe çështja është hedhur poshtë plotësisht nga gjykata. Për shembull: Analiza e ADN-së tregon që i padituri nuk është babai biologjik.

HEDHJE POSHTË PA TË DREJTË ANKIMIMI: Kërkesa është hedhur poshtë, por mund të paraqitet sërish më vonë në gjykatë. Për shembull, nuk ka shërbim për dërgimin e fletëthirrjes.

I

I PADITURI: Personi që i përgjigjet padisë; pala kundër të cilës është ngritur padia.

I PAGUARI: Personi ose organizata në emër të të cilit paguhen paratë e mbështetjes financiare për fëmijën, p.sh, gjyshja e fëmijës

I VARUR: Një fëmijë që është nën kujdesin e dikujt tjetër. Pjesa më e madhe e fëmijëve që kualifikohen për mbështetje financiare janë të varur.

J

JURIDIKSION JOEKSKLUZIV: Një urdhër që lejon më shumë se një gjykatë të marrë vendime rreth modifikimit të një urdhri mbështetjeje financiare për fëmijën. Kjo mund të ndodhë me Gjykatën Supreme të shtetit të Nju-Jorkut dhe me Gjykatën e Çështjeve Familjare.

JURIDIKSION: Autoriteti ligjor që ka një gjykatë ose agjenci administrative mbi persona të caktuar dhe mbi lloje të caktuara çështjesh, zakonisht në një zonë të caktuar gjeografike.

JURIDIKSONI I ZGJERUAR: Dispozitë ligjore që lejon një shtet të pretendojë juridiksion personal mbi dikë që jeton në një shtet tjetër.

K

KËRKESË PËR MODIFIKIM: Kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar një gjykate me anë të së cilës kërkohet ndryshim në urdhrin ekzistues të mbështetjes financiare për fëmijën.

KËRKESË PËR PËRCAKTIMIN E ATËSISË (OSE ATËSISË/MËMËSISË):

Kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar një gjykate me anë të së cilës kërkohet veprim gjyqësor për të përcaktuar atësinë ligjore të një personi të caktuar për një fëmijë të caktuar.

KËRKESË: Kërkesë zyrtare me shkrim drejtuar një gjykate me anë të së cilës kërkohet veprim nga gjykata.

KOMPENSIM: Kompensim ligjor.

KOMPENSIMI ME ANË TË RIMBURSIMIT TË TAKSAVE: Procesi me anë të cilit merren rimbursimet e taksave të prindit jokujdestar për të shlyer borxhin e mbështetjes financiare për fëmijën.

KONFISKIM: Procedurë gjyqësore me anë të së cilës mbahet një pjesë e pagës dhe/ose asetëve të një personi për të paguar një borxh siç mund të jetë mbështetja financiare për fëmijën.

KONFISKIMI I PRONËS (PEX): Procesi administrativ me anë të të cilit OCSS-ja sekuestron asetet financiare, zakonisht llogaritë bankare, të prindit jokujdestar, i cili nuk ka paguar shumën e mbështetjes financiare për fëmijën.

KUJDESTARI: Vendim ligjor që përcakton me kë duhet të jetojë fëmija: nënën, babin ose një të rritur tjetër.

KUNDËRSHTIM: Pretendim me shkrim që kundërshton pika të caktuara në një urdhër. Duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së urdhrit.

L

LIGJI I STANDARDEVE PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR FËMIJËN (CSSA): Legjislacion i miratuar në vitin 1989 për t'i bërë urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën të drejta dhe konsistente në të gjithë shtetin e Nju-Jorkut, duke standardizuar formulën për llogaritjen e urdhrave bazë të mbështetjes financiare për fëmijën.

LIGJI PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË FAMILJES: Ligji i miratuar në vitin 1988 që kërkon mbajtje të menjëhershme nga paga të urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën dhe u kërkon shteteve të përdorin udhëzime për të vendosur shumën e mbështetjes financiare për çdo familje.

LIGJI PËR MBROJTJEN E KREDITIT TË KONSUMATORIT (CCPA): Ligji federal që kufizon shumën që mund të mbahet nga të ardhurat; merr në konsideratë të ardhurat neto pas heqjes së taksave të detyrueshme, shumën e detyrimeve të prapambetura dhe nëse një familje tjetër po mbështetet financiarisht.

M

MAGJISTRATI MBËSHETËS: Juristi i caktuar nga Gjykata e Çështjeve Familjare lokale, i cili mund të dëgjojë dëshmitë dhe të marrë vendime për çështjet e mbështetjes financiare për fëmijën.

MARRËSI: Person ose organizatë që merr fonde mbështetëse dhe/ose përfitime nga ndihma publike, duke përfshirë ndihmë ekonomike, SNAP (ndihma ushqimore), Medicaid, etj.

MARRËVESHJE: Marrëveshje me shkrim nga palët e anëve të ndryshme të një çështjeje.

MBAJTJA E PAGËS: Zbritje automatike nga të ardhurat që fillon sapo urdhri për zbritjen nga të ardhurat i dërgohet punëdhënësit.

mbështetës.

MBËSHETJA ME EFEKT PRAPAVEPRUES: Mbështetje financiare për fëmijën që është urdhëruar të paguhet për një periudhë kohore të kaluar, zakonisht datën kur është bërë kërkesa. Mbështetja me efekt prapaveprues krijon një borxh të menjëhershëm.

MBËSHETJE MJEKËSORE: Dispozitë ligjore që parashikon përfshirjen e mbulimit mjekësor në urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën.

MOSPAGESË E QËLLIMSHME: Prindi jokujdestar nuk paguan qëllimisht mbështetjen financiare për fëmijën të urdhëruar nga gjykata edhe pse ai ose ajo e ka mundësinë për ta paguar.

N

NDIHMË EKONOMIKE: Përfitim nga qeveria që ofron mbështetje financiare për individët dhe familjet me të ardhura shumë të ulëta, që administrohet në qytetin e Nju-Jorkut nga HRA (Administrata e Burimeve Njerëzore). Ndihma ekonomike i jepet klientëve në mënyrë elektronike me anë të EBT-së (Transferimi Elektronik i Përfitimeve).

NDRYSHIMI I RRETHANAVE: Ndryshim i papritur në situatën financiare të prindit jokujdestar për shkak të lëndimit, sëmundjes ose humbjes së papritur të punësimit që ndikon në aftësinë e tyre për të paguar mbështetjen financiare për fëmijën të urdhëruar nga gjykata; arsye për kërkimin e një modifikimi për uljen e shumës në gjykatë.

NDRYSHIMI I TË PAGUARIT: Mundëson që pagesat private të mbështetjes financiare për fëmijën t'i dërgohen OCSS-së për përpunim, për ruajtje të dhënash, shpërndarje dhe ekzekutim të detyrueshëm.

NGRIRJA E PRONËS: Ngrirja e pronës për të parandaluar shitjen ose transferimin derisa të shlyhet borxhi.

NIVELI I VARFËRISË: Niveli i të ardhurave që konsiderohet shumë i ulët për të plotësuar nevojat bazë të jetës sipas qeverisë federale. Niveli i varfërisë në vitin 2021 për një person ishte \$12,880. Për çdo person të shtuar në familje, shtohen \$4,540. Udhëzimet për varfërinë publikohen çdo vit nga Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore (U.S. Department of Health and Human Services) në adresën [aspe.hhs.gov/poverty-guidelines](https://www.hhs.gov/poverty-guidelines).

NJËSIA E ARKËTIMIT TË DETYRIMIT TË MBËSHETJES FINANCIARE (SCU): Sektori i Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën përgjegjës për mbledhjen, monitorimin dhe shpërndarjen e pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën.

NJOFTIM PËR NDIHMË MJEKËSORE KOMBËTARE (NMSN): Njoftim që i dërgohet punëdhënësit të prindit jokujdestar kur kërkohet që të mbulohet sigurimi shëndetësor kur të jetë i disponueshëm.

NJOHJA E ATËSISË/MËMËSISË (AOP): Formular që përcakton atësinë/mëmësinë (babain ligjor) të një fëmije përmes një procesi të vullnetshëm, pa shkuar në gjykatë. Duhet të plotësohet dhe nënshkruhet nga të dy prindërit.

NOTERIZIM: Certifikimi i diçkaje, si për shembull një nënshkrimi, në një dokument ligjor, si autentik ose legjitim duke vendosur një vulë dhe nënshkrim.

NUMRI I ÇËSHTJES: Numri i përcaktuar nga gjykata për të identifikuar çështjen.

NUNC PRO TUNC: Përkthimi në latinisht i shprehjes 'tani për atëherë' – i referohet ndryshimit të datës së një urdhri, gjykimi, ose dorëzimi të një dokumenti, në një datë më të hershme.

P

PADITËSI: Personi ose organizata që paraqet një kërkesë zyrtare për të nisur një veprim nga gjykata.

PAGESA TË PRAPAMBETURA: Shumë mbështetjeje financiare për fëmijën që i ka kaluar afati dhe nuk është paguar.

PAGESA TRANZITORE: Marrësit e ndihmës ekonomike me urdhra mbështetjeje financiare për fëmijën mund të marrin deri në \$100 në muaj (ose \$200 për dy ose më shumë fëmijë që marrin mbështetje financiare) nga mbështetja e mbledhur brenda muajit; e quajtur gjithashtu edhe pagesë bonus.

PAGESAT E AKUMULUARA: Shuma e pagesave të papaguara të mbështetjes financiare për fëmijën. (Gjithashtu shihni “Detyrimet e prapambetura”)

PAGESË BONUS: Marrësit e ndihmës ekonomike me urdhra mbështetje financiare për fëmijën mund të marrin deri në \$100 në muaj (\$200 për dy ose më shumë fëmijë që marrin mbështetje financiare për fëmijën) nga mbështetja e mbledhur brenda muajit. (Shihni edhe Pagesën Tranzitore).

PAGUESI: Personi që bën një pagesë, zakonisht prindi jokujdestar ose dikush që vepron për llogari të tij ose saj. Njihet edhe si obliguesi.

PALA: Personi ose organizata e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në një çështje ligjore.

PENGIMI I FITIMEVE TË LOTARISË: Procesi me anë të të cilit fitimet e çmimeve të lotarisë së prindit jokujdestar dërgohen në Zyrën e Ekzekutimit të Detyrueshëm të Mbështetjes Financiare për Fëmijën për të shlyer detyrimet e pagesave të vonuara.

PENGIMI: Metodë për të siguruar mbështetjen financiare për fëmijën duke marrë një pjesë të pagesave jo nga paga që merr prindi jokujdestar. Pagesat jo nga paga që pengohen përfshijnë rimbursimet e taksave dhe fitimet nga lotaritë.

PËRCAKTIMI: Procesi i vërtetimit të atësisë/mëmësisë dhe/ose marrja e një urdhri gjykatë për të përcaktuar një mbështetje financiare për fëmijën.

PËRFUNDIMET PËR FAKTET E PARAQITURA: Shënime dhe llogaritje që përdoren nga magjistrati mbështetës për të përcaktuar një urdhër mbështetje financiare për fëmijën.

PËRFUNDIMI I NJË URDHRI: Përfundimi i detyrimit aktual; siguroni datën efektive të përfundimit të një urdhri për mbështetjen financiare për fëmijën. Megjithatë pagesat e prapambetura duhet të paguhen.

PIN (Numri Personal i Identifikimit): Numër unik identifikimi i klientëve që përdoret për të aksesuar informacionin e llogarisë së tyre të mbështetjes financiare për fëmijën nga faqja e internetit të shtetit të Nju-Jorkut për mbështetjen financiare për fëmijën (childsupport.ny.gov) dhe nga linja telefonike e ndihmës (888-208-4485).

PRIND JO I PRANISHËM: Person që nuk është i pranishëm në shtëpi dhe është përgjegjës ligjrisht për dhënien e mbështetjes financiare për një fëmijë të varur (referuar gjithashtu si prindi jokujdestar, prindi që nuk banon me fëmijën, dhe i padituri në një çështje në gjykatë).

PRIND JOKUJDESTAR (NCP): Prindi që nuk jeton me të miturin dhe nuk është kujdestari parësor i tij.

PRINDI KUJDESTAR (CP): Prindi, i afërmi ose kujdestari që jeton me fëmijën ose fëmijët dhe është kujdestari parësor i tij/tyre.

PRO SE: Përkthimi në latinisht i shprehjes “për veten”; dikush që përfaqëson veten në gjykatë pa avokat.

PROCES ADMINISTRATIV: Metodat me anë të të cilave OCSS-ja realizon ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrave të mbështetjes pa iu drejtuar gjykatës dhe gjyqtarëve.

QENDËR PUNE: Pika e hyrjes për personat që kërkojnë ndihmë ekonomike. Ofron një pikë aksesimi për të kërkuar punë, trajnime, dhe marrjen e përfitimeve si Medicaid dhe SNAP, ose ndihmave ushqimore. OCSS-ja merr referimeve nga qendrat e punës për klientët të cilëve u kërkohet të bashkëpunojnë me programin e mbështetjes financiare për fëmijën.

R

RAPORTIMI I PUNËSIMEVE TË REJA: Program që u kërkon të gjithë punëdhënësve të raportojnë punonjësit e rinj në Drejtorinë e Punësimeve të Reja të shtetit të Nju-Jorkut për ekzekutimin e mundshëm të detyrueshëm të mbështetjes financiare dhe mjekësore për fëmijën nga zbritjet prej pagave.

RECIPROCITET: Marrëdhënie në të cilën një shtet ose vend u jep disa privilegje shteteve ose vendeve të tjera me kusht që ata të marrin të njëjtin privilegj.

REZERVA E VETËMBËSHTETJES: Faktor në llogaritjen e mbështetjes financiare për fëmijën në shtetin e Nju-Jorkut kur njëri prej prindërve është në ose afër nivelit të varfërisë; rezerva e vetëmbështetjes është 135% e nivelit federal të varfërisë. Rezerva e vetëmbështetjes për vitin 2021 ishte \$17,388.

S

SANKSION: Penalitet për shkelje ose mungesë bashkëpunimi. Në OCSS, i referohet reduktimit të përfitimeve që i bëhen një klienti që merr ndihmë ekonomike për shkak të mosbashkëpunimit me kërkesat e mbështetjes financiare për fëmijën.

SEANCË GJYQËSORE: Procedurë ligjore që zhvillohet në prani të gjyqtarit. Gjyqtari në një seancë gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën quhet Magjistrat mbështetës.

SHËRBIMET E GJETJES SË VENDNDODHJES SË PRINDIT: Rrjeti i kompjuterizuar i bazave të të dhënave shtetërore që përdoret për të gjetur të anketuarit në çështjet e mbështetjes financiare për fëmijën.

Shërbimet e Mbështetjes së Gjykatës së Çështjeve Familjare (FCSS): Sektori i OCSS-së që merret me çështjet vendase të mbështetjes financiare për fëmijën që nuk marrin ndihmë ekonomike.

SHËRBIMI FEDERAL I GJETJES SË VENDNDODHJES SË PRINDIT (FPLS): Shërbimi i kompjuterizuar i rrjetit kombëtar të vendndodhjes që ndihmon shtetet të gjejnë prindërit jokujdestar duke përputhur informacionin e bazës së të dhënave; FPLS-ja mund të ofrojë informacione të dobishme për përcaktimin e kujdestarisë, atësisë/ mëmësisë dhe mbështetjes financiare për fëmijën dhe për çështjet e birësimin dhe kujdestarisë.

SHFUQIZIMI I NJË URDHRI: Heqja e një urdhri të mëparshëm, si të mos kishte ekzistuar.

SHTYRJE: Shtyrja e përkohshme e një seance gjyqësore deri në një datë specifike në të ardhmen.

SHUMA E DETYRIMIT: Shuma që i kërkohet të paguajë prindit jokujdestar si mbështetje financiare për fëmijën.

SHUMA E PARAVE E PËRCAKTUAR NGA GJYKATA: Shuma specifike e detyrimeve të prapambetura të përcaktuara nga magjistrati mbështetës në një vendim zyrtar, i cili përlogaritet me 9% interes në vit. Kërkesa për përcaktimin e shumës së parave mund të bëhet edhe pranë zyrës së Nëpunësit të Qarkut.

SHUMA PËRKATËSE: Pjesa e shumës totale që duhet të paguajë secili prind për pikat e përfshira në urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën, si p.sh. kujdesi për fëmijën ose shpenzimet mjekësore pa rimbursim.

SHUMA SHITESË (E quajtur gjithashtu shuma e shtuar): Shuma që do të paguhet nga zbritja prej të ardhurave përveç detyrimit të urdhëruar nga gjykata të mbështetjes financiare për fëmijën për të plotësuar shumën e papaguar.

SHUMË E PAPAGUAR: Një shumë parash që duhet të paguhet në një çështje mbështetje financiare për fëmijën, por nuk është paguar.

STEP (Programi i mbështetjes përmes punësimit): Ofron trajnime pune dhe punësim për prindërit jokujdestarë që nuk kanë mundësi të paguajnë mbështetjen financiare për fëmijën pasi nuk janë të punësuar ose kanë punë me pagë të ulët. Në seancën gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën mund të bëhen referime për në STEP.

T

TË ARDHURA TË DISPONUESHME: Shuma e të ardhurave të mbetura pas taksave dhe Medicare, FICA dhe zbritjet e pagesës së planit të pensionit nuk llogariten.

TË ARDHURA: Çdo formë e rregullt pagese për një individ, pavarësisht nga burimi, duke përfshirë pagat, komisionet, shpërblimet, sigurimin e papunësisë, kompensimin e punonjësit, invaliditetit, pensionin ose interesin. Ndihma ekonomike dhe përfitimet nga SSI-ja nuk konsiderohen të ardhura.

U

UIFSA (Ligji uniform ndërshtetëror për mbështetjen financiare të familjes): Ligj federal i miratuar në vitin 1996 për të lehtësuar procesin e marrjes së pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën në të gjithë shtetet. Ai kërkon që shtetet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të marrë dhe ekzekutuar urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën; i lejon shtetet të miratojnë mbajtjen e drejtpërdrejtë të të ardhurave nga punëdhënësit në shtetet e tjera; parandalon lëshimin e urdhrave të shumëfishtë të mbështetjes financiare për fëmijën për të njëjtën çështje në shtete të ndryshme.

URDHËR GJYKATE: Dokument ligjor detyruar i lëshuar nga një gjykatë. Një urdhër gjykate në lidhje me mbështetjen financiare për fëmijën përcakton sa shpesh, në çfarë shume, për sa kohë dhe çfarë lloj mbështetjeje duhet të paguajë prindi jokujdestar dhe nëse punëdhënësi duhet ta mbajë mbështetjen nga pagat e tij/saj.

URDHËR I DREJTPËRDREJTË PAGESE: Urdhri i mbështetjes financiare për fëmijën paguhet drejtpërdrejt nga prindi jokujdestar për prindin jokujdestar.

URDHËR I MBËSHTETJES FINANCIARE: Urdhër i lëshuar nga gjykata që përcakton detyrimin për mbështetje financiare për fëmijën. Urdhrat e mbështetjes financiare mund të jenë të përkohshëm ose përfundimtarë dhe mund të modifikohen. Urdhrat e mbështetjes financiare mund të përfshijnë mbështetje monetare dhe mjekësore, kujdesin ndaj fëmijës, shpenzimet e arsimit dhe pagesën e detyrimeve të prapambetura, interesat, gjobot dhe forma të tjera lehtësimi.

URDHËR I NJOHJES SË ATËSISË: Urdhër gjykate që përcakton babanë ligjor.

URDHËR I VEÇANTË MBËSHTETJEJE FINANCIARE PËR FËMIJËN: Urdhër që rendit shumën që duhet paguar për çdo fëmijë.

URDHËR MBROJTJEJE: Direktivë e gjykatës që ndalon kontaktin/komunikim mes palëve.

URDHËR ME PËLQIM NGA TË DYJA PALËT: Urdhër për të cilin kanë rënë dakord të dyja palët. Në një seancë gjyqësore të mbështetjes financiare për fëmijën, prindërit mund të bien dakord për një shumë të ndryshme nga ajo që përcaktojnë udhëzimet në Ligjin për Standardet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën.

URDHËR PËR MBAJTJEN E TË ARDHURAVE (IWO): Procesi administrativ me anë të të cilit pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën të prindit jokujdestar zbriten drejtpërdrejt nga paga ose të ardhurat e tij ose saj dhe dërgohen në Njësinë e Marrjes së Mbështetjes Financiare për Fëmijën. Mund të quhen mbajtje të pagës, konfiskime, ose zbritje nga paga.

URDHËR STANDARD: Urdhër mbështetjeje financiare për fëmijën që jepet kur prindi jokujdestar nuk jep informacion të mjaftueshëm ose nuk paraqitet në gjykatë, kur paraqiten prova për dorëzimin e fletëthirrjes.

URDHËR: Urdhër i shkruar dhe i nënshkruar i një magjistrati mbështetës ose gjyqtari.

V

VENDIM: Vendim juridik i gjykatës.

VETËM NDIHMË MJEKËSORE (MAO), OSE VETËM MEDICAID:

Formë ndihme publike që ofron përfitime për përfituesit vetëm në formën e ndihmës mjekësore dhe jo financiare.

Z

ZYRA E REGJISTRIMIT TË ATËSISË SË PRETENDUAR (PFR):

Të dhënat e atësisë të mbajtura nga shteti i Nju-Jorkut. Shembuj të dokumenteve që ruhen në PFR janë formularët për njohjen e atësisë/mëmësisë (AOP), urdhrat e gjykatës që përcaktojnë atësinë/mëmësinë, dhe deklaratat joligjore që lidhen me përcaktimin e atësisë/mëmësisë. PFR-ja mund të konsultohet për çështjet që lidhen me trashëgiminë, birësimin dhe çdo çështje tjetër që kërkon njoftimin e babait të fëmijës.

ZYRA E SHËRBIMEVE TË MBËSHTETJES FINANCIARE

PËR FËMIJËN: Sektori i Administratës së Burimeve Njerëzore përgjegjës për marrjen dhe ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrave të mbështetjes financiare për fëmijën për familjet që jetojnë në qytetin e Nju-Jorkut.





@NYCHRA



NYCHRA



NYCHRA

BK-4 (AL)
Rev. 10/2024

© E drejta e autorit 2024. Qyteti i Nju-Jorkut, Administrata e Burimeve Njerëzore/Departamenti i Shërbimeve Sociale Për Leje për të shumëfishuar të gjithë ose një pjesë të këtij materiali, kontaktoni Administratën e Burimeve Njerëzore të Qytetit të Nju-Jorkut.